



DRITA ISLAME

Botim i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë / Çmimi: 250 Lekë / www.dritaislame.al

Viti XXXIV / Nr. 07 / Korrik 2025



TË MBASH NDEZUR NË ZEMËR
dritën e besimit



“DRITA ISLAME”

**Botim i Komunitetit Mysliman
të Shqipërisë**

www.dritaislame.al

DREJTOR

Dorian Demetja

KRYEREDAKTOR

Mehmet Disha

DIZAJNI DHE FAQOSJA

Erzen Carja

KONTAKT:

Tel/fax +355 68 87 71 655

E-mail: mehmet.disha@kmsb.al


Viti XXXIV i botimit

Nr. 07 (506)


Korrik, 2025

ISSN 2226-7115

*Artikujt
që vijnë në redaksi
dhe botohen, nuk
paraqesin domosdoshmërisht
edhe pikëpamjet e revistës.*



www.dritaislame.al



editorial

- 04** Të mbash në zemër ndezur dritën e besimit
Mehmet Disha

në fokus

- 06** Shpirti i civilizimit islam
Dr. Muhamed Amareh

lajme / aktivitete

- 10** 01-Besimtarët myslimanë festojnë Kurban Bajramin
02-Kolegji Universitar "Bedër" diplomon brezin e 12-të të studentëve
03-Zhvillohet mbledhja e përbashkët me administratorët e rretheve
04-Zhvillohen mbledhjet vjetore me myftinitë e vendit

refleksione

- 16** Një burrë, një grua në zemër të modernitetit
Tarik Ramadan

çështje fetare

- 20** Etika e xhumasë
Këshilli për Çështjet Fetare – insi.al

familja

- 22** Mënyra e debatit dhe komunikimi në familje
Armand Asllani

horizonti i besimit

- 26** Horizonti i fesë
Dorian Demetja
28 Lumturia dhe besimi
Lejla Dervishi
30 Mendimi i Imam Taberit për luftën dhe paqen me armiqët / Prof.dr.hfz. Hajredin Hoxha
32 Një ditë e profetit Muhamed a.s.
Tauland Bica

bota shpirtërore


- 34** Krijuesi, dashuria ime e vetme
Redaksia

hapësirë fëminore

- 36** Pagjumësia e mbretit shpëtoi një njeri në nevojë
Hapësire Fëminore

këndi i poezisë

- 38** Zgjohu o njeri
Ferit Vokopola



Të mbash në zemër ndezur
DRITËN E BESIMIT

Vrulli i shpejtë dhe i lëmshtë me të cilin po ecin ditët, nxit nevojën çdo ditë e më shumë të meditimit dhe të reflektimit për t'i dhënë kështu zemrës mundësinë për të mos u përparë nga ky vrull, që zemra të mund të mendojë e qetë për spovat, të mos përfshihet në dashurinë e dynjasë që është kreu i të gjitha belëve, të mos bëhet pjesë e haramëve dhe rrugëve që ndërpresin mirësitë e Zotit dhe ftojnë dënimet e Tij, si dhe të mos harrohet qëllimi kryesor i ardhjes në këtë jetë dhe që është adhurimi (njohja) e Krijuesit.¹

Çdo gjë rrjedh dhe duhet të rrjedhë drejt natyrshmërisë për të cilën është krijuar. Sa herë që shfaqen probleme, shqetësime, qoftë në të jashtmen e njeriut, apo në të brendshmen e tij, kjo ndodh për arsye se është prishur ajo rrjedhë e natyrshmërisë. Vërtetësia e kësaj rrjedhe vërehet nga vazhdimësia e saj, nëse shkakton probleme në ndërgjegje, nëse jep shkundje, lëkundje e trandje, nëse vazhdimisht e tjetëron njerin derisa ai vetë të besojë te iluzioni i përkohshëm i lumturisë dhe ta pandehë atë për të natyrshme dhe të qenë, atëherë, duhet kuptuar që janë prishur telat e gjësë dhe natyra e njeriut është kontaminuar. Për këtë arsye lind nevoja për tërheqje për zbrapsje, sepse nëse vazhdohet, Zot ruana, rrjedha ka thepisje e ujëvara në rënie që nuk dihet se ku e kanë fundin...

Për lehtësimin e rrugës, për pastrimin e ujrave të turbullt të ndërgjegjes, për shërimin e brengave, për pastrimin e rrjedhës dhe për rikthimin drejt natyrshmërisë, për rikapjen e fillit, na është lënë Kur'ani, drita e Zotit që është shërim, mëshirë dhe litar i fortë i Krijuesit; zbritur e lënë për njerëzit si mirësi e jashtëzakonshme, si edhe udha e sunetit profetik, e mësuesit të parë të Kur'anit, të cilit iu zbrit si libër, si shpallje, dhe që është udhërrëfyesi i shtigjeve të ngushta për në gjerësinë e madhe të besimit dhe Islamit, pra këshillat dhe jeta e të dërguarit të Zotit, Muhamedit ﷺ.

Kur'ani thërret pikërisht te kjo natyrshmëri, e cila është e natyrshme dhe e domosdoshme për njeriun:

فَاقِمِ وَجْهَكَ لِلدِّينِ حَنِيفًا ۖ فِطْرَتَ اللَّهِ الَّتِي فَطَرَ النَّاسَ عَلَيْهَا ۚ لَا تَبْدِيلَ لِخَلْقِ اللَّهِ ۚ ذَٰلِكَ الدِّينُ الْقَيِّمُ وَلَكِنَّ أَكْثَرَ النَّاسِ لَا يَعْلَمُونَ

"Kështu që drejtoje fytyrën me përkushtim në fenë e pastër monotheiste, natyrën fillestare, në të cilën Allahu i ka krijuar njerëzit. S'ka ndryshim të krijimit të Allahut. Kjo është feja e drejtë, por shumica e njerëzve nuk e dinë."²

Në këto ditë të trazuara, njeriu duhet të rikthehet në strehën e besimit dhe të mbështetjes te Zoti. Të rikujtojë edhe një herë se është i përkohshëm. Të kuptojë dorëzimin. Islami si fe është fe e dorëzimit të vullnetit duke ndjekur urtësinë, dashurinë dhe udhëzimi e Krijuesit Fuqiplotë. Kjo botë është thjesht një stacion. Allahu ﷻ është i mirë dhe i urtë. Ai ka gjithçka në dorë. Çdo punë e bën mirë. Çdo gjë e krijon dhe e sjell aq bukur. Këtu në këtë dynja është ara që mbillet dhe frytet e së cilës jepen në ahiret. Këtu është arena ku dallohet i miri nga i keqi, do ketë sprova e vështirësi, ku selektohen shpirtat në bazë të vullnetit që kanë dhe se si e përdorin, në bazë të prirjes së tyre, qymyri ndahet nga diamanti, zifti nga smeraldi, guri nga rubini e kështu me radhë. Udhëzimi bie si mirësi e Zotit, si dhe udha e gabuar gjen ata që e meritojnë. "Ne padyshim për çdo popull (ummet) kemi zbritur të dërguar të cilët i patën këshilluar duke u tërhequr vërejtjen që të adhurojnë vetëm Allahun e të largohen nga e keqja e shejtanit. Kështu ka prej tyre që Allahu i udhëzoi, e ka prej tyre që e patën hak (me meritë) çudhëzimin (rrugën e gabuar). Pra udhëtoni nëpër tokë e shihni se ç'përfundim patën mendjemëdhenjtë!"³

Ridimensionimi i besimitarit është më se i domosdoshëm herë pas here. Kështu është e mundur mbajtja dhe ruajtja e istikametit-vazhdimësisë. Të mbash në zemër ndezur dritën e shpresës, të forcosh besimin, të mendosh mirë për të nesërmen, të heqësh çdo ditë perdet e përhumbjes duke i kujtuar vetes se Zoti ka në dorë çdo ndodhi e ngjarje, çdo grimcë e çdo atom, çdo luftë e çdo betejë, çdo gjallesë a send, të falësh namazet të pesta, të rinovosh lidhjen me Zotin çdo mëngjes, të falësh veten, të tjerët, të heqësh prej zemrës mllefet, janë prej punëve të nevojshme që mund të bëjë besimtari kësokohe. Sado i lëmshtë të jetë moderniteti dhe koha në të cilën bashkëjetojmë, Allahu ka çdo gjë në dorë dhe tek Ai është filli i punëve. Zemra duhet mbajtur qetë, si një anije që nuk fut ujë brenda, por lundron në këtë det, e në atë det, e në tjetrin, e kalon kështu dynjanë, ecën për në berzah-jetën e varrit, kësisoj drejt ringjalljes në mahsher, del përpara Zotit dhe vazhdon për në xhenetet e Tij derisa të mbërrijë tek Krijuesi i gjithëdashur e i Gjithëurtë!

Zot na lartëso me fenë Tënde e na tërhiq për tek e natyrshmja dhe e bukura, mos na përul me sisteme të tjera, a me idetë e nefsit dhe të shejtanit duke na rrokullisur drejt të keqes dhe të shëmtuarës, vërtetë Ti je Falës e pranues i lutjes! Amin!

1. Kur'an, Dharijat, 51:56.

2. Kur'an, Rum, 30:30.

3. Kur'an, Nahl, 16:36.

SHPIRTI I CIVILIZIMIT ISLAM

Industria e rëndë, të cilën thirrja islame e ngriti qysh prej periudhës së Mekës, ishte, padyshim, industria e formimit islam ndaj njeriut që përqafoi Fenë Islame.

'Shtëpia e Erkam Bin Erkam' në periudhën kur thirrja islame mbahej e fshehtë, domethënë qysh prej fillimit të asaj thirrjeje, ishte e para e institucioneve edukative të cilën e ngriti Profeti i Islamit, paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të.

Para se myslimanët të pushtonin qytetet dhe vendet dhe para ngritjes së shtetit, ndryshimit të realitetit, zbatimit të ligjit dhe kristalizimit të marrëdhënieve shoqërore, ishte pushtimi islamik i zemrave dhe i mendjeve nga udhëzimi i Kur'anit Kerim. Ai udhëzim u bë morali, sjellja, praktika dhe karakteristika e jetës me të cilat jetojnë myslimanët. Madje, të parin prej qyteteve që pushtuan myslimanët para Hixhretit Profetik dhe para shtetit islam -që ishte Medina- ata e pushtuan me Kur'anin Kerim.

Pas realizimit të formimit Islam -nëpërmjet edukimit- të njeriut, erdhën të gjitha arritjet dhe pushtimet në fushat e civilizimit, të shkencave të tij, kulturës, etikës dhe të artit -si mishërimi i kësaj që parapriu dhe që u realizua në personin e njeriut. Të gjitha ato erdhën të përpiluara me kriteret Islame, të cilat paraprinë dhe projektuan personat, mendjet dhe zemrat e atyre që u udhëzuan me Udhëzimin e Kur'anit.

Thirrja fetare në Islam nuk ndaloj tek limitet e përqaimit të fesë nga ana e njeriut dhe të përmbushjes së adhurimit ndaj Allahut nëpërmjet riteve që shprehin besimin e zemrës dhe që deklarojnë qartë lidhjen e tij me qiellin, por kjo thirrje u zgjerua dhe u shtri për të realizuar koalicionin e njeriut me umetin, me shoqërinë dhe me universin. Kështu, në personalitetin

e këtij njeriu u bënë bashkë Botët e të Padukshmes dhe të Dukshmes. Tek ai u bashkuan dhe u ekuilibruan lidhjet e individit me shoqërinë, e veçanta me të përgjithshmen. Ato e përqafoi dynjanë, me qëndrimin e tyre në të, kur Islami i dha formim personit të njeriut mysliman, ndërgjegjes dhe mendjes së tij, atë formim në të cilin u bënë bashkë dhe u ekuilibruan ajetet e Allahut në Shpalljen Qiellore me ajetet -shenjat- tek individët dhe horizontet.

Feja Islame nuk ngrihet dhe nuk qëndron në beqarinë individuale dhe në shpëtimin personal, por ajo kërkon medoemos, për ngritjen e saj dhe për realizimin e plotë të të gjitha detyrimeve të saja, umet, atdhe, bashkim, shoqëri dhe detyrime sociale tek të cilat të orientohet adresimi dhe obligimi i umetit me to. Këto detyrime shoqërore janë më të rëndësishme dhe më të sigurta se sa detyrimet individuale, me argumentin se, mëkati i mosplotësimit të detyrimit individual bie mbi vetë individin, kurse mëkati i mosplotësimit të detyrimit shoqëror bie mbi të gjithë umetin.

Në fenë Islame, Hixhreti -Emigrimi- në Rugën e Allahut u bashkëshoqërua me ngritjen e shtetit e të shoqërisë dhe me zbatimin e ligjit. Ngritja e strukturës shoqërore midis nënshtetasve bën realitet arritjen e vëllazërisë, jo thjesht në të drejtat fetare, por edhe në çështjet e jetës, gjithashtu. Madje kjo strukturë është shtrirë në kriteret e qytetarisë e të kombësisë; madje deri tek kundërshtimi në fe, sa që kjo strukturë i përfshiu bashkë jomyslimanët me myslimanët. Kështu, Hixhreti nuk është monakizëm për t'u pastruar me të dhe vetëm nëpërmjet tij duke qenë i mbyllur nga jeta dhe i veçuar nga njerëzit, por monakizmi i umetit është xhihadi, i



cili bën të domosdoshëm ekzistencën e umetit, atdheut dhe shoqërisë.

Thirrja fetare Islame ka prodhuar një rezultat të formimit edukativ të personaliteti i individit mysliman. Ai u bë një faktor psikologjik dhe realizoi bashkimin e elementeve individuale në shoqërinë Islame, prej elementeve natyrorë e ligjorë, prej atyre civilizuës e fetarë, prej atyre logjikë dhe të njohurisë së transmetuar dhe prej atyre materialë e të thjeshtë. Ai koalicion ishte një civilizim Islamik që e solli njeriu, të cilin e formoi thirrja Islame, dhe ajo është një veçori prej veçorive të fesë Islame dhe të civilizimit Islamik. Mesazhet fetare që paraprinë mesazhin e fundit të Islamit, ose ishin në sinkroni me civilizime jofetare dhe bashkëjetuan me to duke mos i ndryshuar ato dhe duke mos i ngjyrosur me ngjyrimin e tyre për shkak se ato mesazhe qëndruan thjesht tek limitet e fesë, ose ato civilizime, të cilat paraprinë civilizimin Islamik, jetuan në kohët e periudhës 'El-Fitretu', e cila nuk pati mesazhe qiellore.

Dallimi i Islamit, është se ai solli qytetërim, formoi civilizim, ngriti shoqëri njerëzore dhe vendosi në mënyrë sintetike në personin e njeriut- nëpërmjet metodologjisë së edukimit të gjithanshëm- atë koalicion të ekuilibruar, i cili e bëri këtë njeri të sjellë një civilizim artificial me ngjyrimin e fesë. Feja Islame, sigurisht, realizoi koalicionin, ekuilibrin dhe sigurinë në personin e njeriut mysliman. Kështu, krijimi civilizuës i këtij njeriu- domethënë civilizimi Islamik- erdhi si një fryt i mishëruar i kësaj që e prodhoi feja në personin e këtij njeriu. Mirëpo kur ky civilizim dhe kultura e tij kaluan dhe u larguan prej këtij ngjyrimi, ndodhi ky defekt të cilin ne po e vuajmë sot dhe i cili ndodhi qysh prej disa shekujsh dhe për kurimin

e sëmundjes së të cilit japin ilaçe të gjitha thirrjet dhe lëvizjet reformatore në umetin e Islamit.

Në qoftë se Islami ishte shkaku i përparimit të myslimanëve për ngritjen civilizuës të tyre dhe për lulëzimin kulturor të tyre, atëherë cili është shkaku i prapambetjes që i goditi myslimanët, pavarësisht vazhdimësisë së Islamit duke qenë në gjendjen e tij ashtu siç ishte atëherë kur bëri të vërshonin burimet e përparimit në jetën islamike? Shkaku, sigurisht, është mungesa e 'shpirtit' (mungesa e shpirtit islam) në civilizim (në civilizimin Islamik). Është ndërprerja e lidhjes midis Islamit dhe civilizimit të myslimanëve. Ky shpirt i cili shkaktoi civilizimin islamik, madje atë të cilin e bëri të vërshonte dhe që e ngjyrosi me ngjyrimin e Islamit.

Hasan Basri, në një rast, u ul pranë një predikuesi, por zemra e tij nuk u ndikua nga predikimi i tij. Hasani e pyeti atë: "O vëlla, a në zemrën tënde ka sëmundje apo në zemrën time?". Kështu, ndërprerja e lidhjes, mungesa e shpirtit është shkaku i sëmundjes dhe qorrsoakaku i civilizimit, për të cilin kërkohet të jepen ilaçe kuruese prej shkollave të ndryshme reformatore. Cili është ky shpirt, i cili e bëri fenë Islame- dhe jo fetë e tjera- të prodhonte civilizim e kulturë dhe i cili nuk qëndron tek thjesht feja? Ku është vendi i defektit, i cili ka ndaluar aktivitetin islamik në civilizim e kulturë, i cili e degradoi civilizimin islamik dhe atrofizoi kulturën islame, pavarësisht vazhdimit të islamit 'si Fe', ashtu siç është, dhe pavarësisht vazhdimit të besimit në të dhe kapjes pas lidhjeve të saja?

Shejh Muhammed el-Fadil Bin A'shur paraqiti për këtë çështje boshtore, kur ai diskutoi rreth saj, pikat vijuese:

Ngritja e civilizimit dhe e kulturës

Dallimi i Islamit si “Fe” është nëpërmjet shfaqjes së civilizimit dhe ngritjes së kulturës. Në qoftë se Islami, si fe, ndan me fetë e tjera qëndrimet lidhur me çështjet e përgjithshme, por ama Islami ka aspekte me të cilat ai veçohet prej atyre feve, të cilat ndajnë me të çështjet fetare në mënyrë të përgjithshme. Sepse Islami ka aspekte lidhjeje me kulturat dhe civilizimet, gjë të cilën nuk e kanë fetë e tjera. Kjo të cilën ne e quajmë ‘Civilizimi Islam’, ose ajo të cilën ne e quajmë ‘Kultura Islame’ janë një varg ngjarjesh, situatash dhe rrethanash shoqërore dhe intelektuale, për të cilat Islami ishte baza e shfaqjes së tyre dhe shkak i formimit të tyre. Islami nuk ndaloj tek bashkëjetesa me shkencën, por çdo çështje shkencore u bë e lidhur me besimin fetar duke u bërë një lidhje midis fesë dhe njohjes intelektuale, ose midis shkencës së natyrës dhe asaj prapa së cilës ekziston lidhja e ndërveprimit dhe ndërthurjes. Nga kjo u shfaq orientimi drejt jetës dhe sjellja në të, ku faktori i besimit fetar është shtytësi në të gjitha aspektet e tij. Shtytësi fetar u manifestua në ngritjen e dijetarit, në produktin e letrarit dhe në formimin e artistit. Njohja shkencore u bë themeli i fjalës së folësit, i fikhut të fekihut-Juristit-, i tesavvufit të sufiut-mistikut dhe i mënyrës që i lidh elementet e njohjes. Ajo nxori librat e akides Islame duke grumbulluar njohuritë rreth natyrës, matematikës dhe humanizmit së bashku me të vërtetat e besimit. Shkenca dhe feja bëhen të njëtrajtshme dhe të pajtueshme në të dhe, tek ajo, e logjikshmja dhe njohuria e transmetuar mbështesin njëra tjetrën.

Shoqëria Islame u formua menjëherë pas thirrjes fetare. Ajo është një shoqëri fetare me kuptimin e saj më të veçantë. Feja ishte faktori i parë i drejtëpërdrejtë në të. Prej thirrjes së fesë dhe besimit tek ajo, populli që iu përgjigj asaj thirrjeje dhe që u dallua me atë besim fitoi tipare të reja shpirtërore. Perceptimet fetare ishin pikërisht ato të cilat i hapën horizontet e gjithësisë para shikimit të myslimanit për shqyrtim, meditim, njohje e besim. Kështu, e vërteta e besimit në Perëndi është themeli i gjithçkaje prej strukturave konkrete dhe abstrakte që i ngriti civilizimi Islamik. Njeriu i këtij civilizimi, nëpërmjet fesë ideoi, nëpërmjet fesë ai prodhoi veprat e civilizimit të tij dhe nëpërmjet fesë ai ngriti shtetin e drejtë dhe civilizimin e tij. Gjithashtu nëpërmjet fesë vazhduan aspektet e civilizimit duke mbetur të lidhura me personin e tij dhe, faktorët e fesë kanë shumë ndikim në aspektet e civilizimit.

Ekulibri dhe harmonia

Gjithashtu, ky civilizim islamik dhe kultura e tij u dalluan me ekuilibrin dhe harmoninë, sepse ato janë rezultati i dallimit të Islamit, i cili bëri realitet integritetin, ekuilibrin dhe harmoninë në burimet e njohjes njerëzore. Të vërtetat që lidhen me materien dhe me ato që gjenden përtej saj janë në kapjen e njeriut. Ai mund të arrijë tek ato nëpërmjet perceptimeve të tij të shumta të klasifikuara e të theksuara, të cilat e mbështesin njëra-tjetrën pa tëhuajtje, pa grindje dhe pa kokëfortësi. Shqisat instinktive kanë nga pas shqisat e perceptimit; pastaj shqisat e perceptimit kanë nga pas perceptimet logjike; pastaj perceptimet logjike çojnë tek parathëniet përçuese

për të marrë perceptimet e të Padukshmes, të cilat vijnë nëpërmjet Vahjit- Shpalljes- dhe, pastaj tek pranimit dhe nënshtrimit. Gjithashtu, këto perceptime mbeten vazhdimisht duke ndihmuar e mbështetur njëra-tjetrën. Nuk mund të përfitohet nëpërmjet një rruge të vetme prej tyre ajo që bie në kundërshtim me rezultatin prej rrugës së një perceptimi tjetër, por megjithatë nëse dikush është i pamundur ta ngërthejë njërin prej atyre dy rrugëve mund të lidhet me një rrugë tjetër prej tyre derisa të përfundojë tek bindja dhe nënshtrimi që fitohen nëpërmjet të jashtëzakonshmes, e cila është Rrugja e Vahjit- Shpalljes. Kështu, mendja e njeriut dhe besimi i tij, perceptimi i tij lëndor dhe ndjenjat e tij instinktive, që të gjitha janë të harmonizuara dhe bashkëpunuese me njëra-tjetrën. Ato nuk kanë frikë nga njëra-tjetra dhe asnjëra prej tyre nuk e pret rrugën e tjetrës.

Civilizimi Islamik ishte vepra e një njeriu, i cili fitoi një gjendje të harmonizuar e të ekuilibruar në vetvete dhe duke qenë i sigurt në vetvete. Ai bëri në modelin e vetvetes një civilizim që e bëri të fitonte atë çfarë ai fitoi. Ai i dha atij civilizimi nga ajo që Allahu i dha atij derisa ai civilizim u ngrit me atë harmoni, ndryshe nga civilizimet e tjerë.

Cilat ishin shkaqet e prapambetjes?

Por çfarë ndodhi që civilizimi islamik mbeti prapa dhe kultura e tij u atrofizua, pavarësisht vazhdimit të Islamit i cili i prodhoi ato dhe realizoi lulëzimin e tyre që zgjati për disa shekuj dhe ato të dyja ishin një fanar ndriçues për botërat? Nuk qe Islami ai që u godit, por ishin kultura Islame dhe civilizimi Islamik. Ato të dyja aspironin prej Islamit, mallëngjeheshin për të dhe shpresonin shërimin e tyre tek ai. I afërti dhe i largëti e kuptonin se ajo që i ra shoqërisë Islame në civilizimin dhe në kulturën e saj nuk ishte asgjë tjetër përveç shmangies prej origjinës, ndryshimit të situatës dhe ikjes prej faktorit edukativ themelor, i cili obligon kapjen pas bazave dhe që konsolidon e sundon situatat. Ajo që goditi civilizimin dhe kulturën e shkëputi vërtetësinë e kërkimit të ndihmës prej Islamit dhe të mbështetjes së fortë tek ai, saqë kolonat bazë të tij anuan dhe u shembën. Defekti nuk ndodhi tek vetë Islami, por u ndal besimi se islami ishte shpirti i civilizimit. Dëshira e besimit konstruktiv për civilizim u tërhoq e u venit. Ndodhi ftohja civilizuese prej fetares dhe ndarja e fesë prej dynjasë.

Shpjegimi i aspektit, të cilin e goditi sëmundja në akide, është pikërisht ai që i zbulon shkaqet të cilat i dhanë goditje civilizimit duke e dobësuar atë dhe duke e atrofizuar. Ajo që ndodhi në akiden Islame dhe që shkaktoi rënien e civilizimit ishte ftohja që e largoi shpirtin e saj prej civilizimit dhe, kështu civilizimi u bë i ngatërruar dhe i pajetë duke mos përparuar. Ajo ftohje ishte veçse njëra prej pasojave të dobësisë e cila e goditi akiden në thelbin e saj. Edhe dëshira e besimit konstruktiv u dobësua dhe u lëngua. Rrethanat shoqërore dhe veprat e civilizimit u bënë të shfaqeshin jo më ashtu siç dukeshin më parë nga akideja. Civilizimi u bë të shfaqej në një luginë, ndërsa akideja në një luginë tjetër. Myslimani vazhdoi që qëndronte besnik ndaj besimit të tij fetar si dhe ishte xheloz e i zellshëm për të nga një aspekt, dhe duke pranuar jetën e tij praktike dhe duke qenë i qetë për realitetin e saj

nga një aspekt tjetër. Saqë parimi teorik dhe realiteti praktik u bënë tek ai të dallueshëm qartë, dhe prej kësaj lindën teoria e ndarjes së fesë nga dynjaja duke e konsideruar fenë një të mirë joreale dhe duke e konsideruar dynjanë si një të keqe reale, dhe se adhuresi mysliman mban midis kraharorit të tij një fe që nuk ka ndikim veçse rrallë dhe se ai jeton në dynja duke mos njohur në të veçse ato gjëra që e largojnë nga feja. Pastaj, në jetën e tij praktike, atë e sulmuan civilizime të huaja për të, në të cilat ndodhen shkenca, industria, fuqia dhe urtësia. Ai nuk gjeti prej dëshirës së tij fetare atë çfarë ofroi për të ky civilizim. Ashtu siç ofruan civilizimet të cilat qenë në kontakt me to më parë, në ditën kur dëshira e tij fetare ishte e fuqishme dhe e shëndetshme, dhe qëndroi para saj i ngrirë e i palëvizshëm duke e konsideruar atë si një tërësi e mënyrave të jetës që ishin më parë dhe besoi ndarjen e tyre nga feja.”

Ky është pikërisht defekti, të cilin Ibn Halduni e perceptoi dhe e analizoi më mirë se kushdo tjetër. Ibn Halduni e analizoi çështjen në mënyrë të hollësishme, kur i bëri çështjet politike, ato të zhvillimit, të industrisë dhe të shkencës në shtetin Islamik të varura nga çështja e fesë, duke e bërë atë të vërtetën parësore të fesë. Ai e bëri atë që është akideja individuale bazën dhe themelin e të gjithë asaj. Ai nisi të studionte problemin e korrupsionit të shtetit dhe amullin e zhvillimit- në shekujt e mëvonshëm të Islamit prej shekujve të tij të mëparshëm- uljen e prodhimeve, ikjen e talenteve të shkencave, mangësinë e mënyrave të mësimdhënies në qytetet Islame të kohës së tij duke e bërë të gjithë këtë t'i referohej defektit të të vërtetës parësore të fesë, e cila është themeli i zhvillimit që shfaqet me të dhe i shtetit të ngritur mbi të, dua të them akiden fetare, duke e kthyer të gjithë atë tek mënyra e formimit të individit me formim fetar që lidhet nga një aspekt me fenë Islame, me akiden e saj, dhe kalon prej saj për tek çdo gjë që buron prej asaj akideje prej fenomeneve të zhvillimit, industrisë dhe të mendimit. Në qoftë se njerëzit qenë të kënaqur të njësoheshin me defektin që u shfaq në shoqërinë islame dhe me civilizimin e saj, gjë e cila u referohet sistemeve të qeverisjes dhe formave të shtetit si dhe prej asaj që u përhap prej prishjes së moralit dhe prej këputjes së lidhjeve shoqërore, Ibn Halduni kërkon shkaqe për këto sëmundje duke ua referuar këto shkaqeve të tyre. Atëherë, transformimi i kalifatit në sundim nuk është një sëmundje por një shkak sëmundjeje që e ndryshoi sanksionin fetar në synime për të sunduar e mposhtur, në kthim në epshe e dëfrime dhe në sjelljen e frymës së shtetit në vend të frymës së fesë. Ibn Halduni e ktheu civilizimin Islamik tek origjina dhe tek baza e tij, ose më qartë, tek shpirti i tij që është akideja Islame.

MADHËSIA E PROBLEMIT

Në qoftë se ky është problemi, atëherë cili është madhësia e tij? Cila është jeta e tij? Madhësia e këtij problemi nuk është e vogël dhe jeta e tij nuk është e shkurtër. Në qoftë se ne nuk e mohojmë se civilizimi Islamik u turr, mbeti prapa dhe u shkëput, se kultura u atrofizua, u ftoh, u venit dhe gati u bë gërmadhë, se ajo nuk është foshnja e djeshme dhe as e djeshmja e saj, por ishin sëmundjet që u bënë të rënda në

shekujt e fundit saqë u bë i vështirë shërimi i tyre; pastaj ato vazhduan të shumohen e përkeqësohen dhe dhimbjet dhe rreziqet e tyre u agravuan derisa kanë mbërritur në këtë situatë të frikshme, saqë shekulli ynë po ankohet në mënyrë shumë të zhurmshme. Cila është zgjidhja? Në përfundim dhe pasi përkufizuam shpirtin e civilizimit Islamik dhe pasi diagnostikuam sëmundjen- defektin- që goditi civilizimin dhe kulturën tonë, atëherë cila është zgjidhja reale e këtij problemi? Cila është dalja prej këtij qorrsoakaku që po ngushton lakun e këtij Umeti dhe që po i zë frymën? Zgjidhja është kthimi tek shpirti i cili prodhoi civilizimin e lulëzuar dhe kulturën e shëndritshme. Është kthimi i shpirtit fetar që t'i japë formë rizgjimit të dalluar të së ardhmes. Ky është kuptimi i vërtetë i thënies, “Nuk do të rregullohet fundi i këtij Umeti veçse me atë që u rregullua fillimi i tij”. Në qoftë se nuk do të ishin formimi individual Mekas dhe formimi kolektiv Medinas, nuk do të ishin veprat e civilizimit që u shfaqën në kryeqytetet e Islamit. Në qoftë se njerëzit sot mallëngjehen për periudhat e arta, në të cilat ato lulëzuan në ato kryeqytete, dhe digjen nga malli për t'i rigjallëruar e ripërtërirë ato, atëherë sa e përshtatshme do të ishte për ata që t'i kthehen faktorit bazë, i cili i prodhoi ato periudha të arta, ai faktor që pa të cilin nuk do të kthehet lulëzimi i atyre shekujve dhe pjekuria e tyre. Ai është faktori edukativ Islamik, i cili formoi individin para se të formonte shoqërinë, dhe shtroi rrugën për kulturën para se të merrte elementet e njohjes, të cilat formuan entitetin e saj. Ndërsa në qoftë se ne do të qëndronim tek ‘pavarësia e flamurit dhe e himnit’ pa të vërtetat e ‘pavarësisë civilizuese’ që është fruti i ngjyrimit të dalluar Islamik, ne nuk do të mund të dalim prej qorrsoakut në të cilin jetojmë sot.

Bota Islame ka dalë prej sundimit të të tjerëve dhe ka rikthyer sovranitetin e saj, por a mundet ajo që ta rikthejë civilizimin e saj dhe t'i marrë përsëri peshat dhe përgjegjësitë duke paraqitur për njerëzit një formë të re kulture dhe civilizimi të stampuar me stampën e personalitetit të saj Islamik dhe të shfaqur prej parimeve të akides Islame, prej të cilës buroi forma e së shkuarës, gjë të cilën e njohu historia prej kulturës së Islamit dhe civilizimit të tij?

Rilindja e Japonisë nuk është budizmi; as rilindja e Kinës nuk është rilindja e konfucianizmit; as rilindja e Greqisë nuk është bizantinizmi, as platonizmi, as aristotelizmi dhe, ajo nuk është as greqizmi në ndonjë mënyrë. A do të ishte e kufizuar çështja e Islamit në këtë gjendje? Apo civilizimi Islamik, shpirti dhe kultura Islamike, do të jetë stampa që do të duket midis asaj sasi të përbashkët të përbërë midis popujve të Umetit Islam që do të rizgjohej në të ardhmen? Ai shpirt i atij civilizimi është vendi kryesor i problemit.

Këto ishin disa prej çështjeve, ideve dhe boshteve të ndërlikuar rreth të cilave janë ngatërruar reformatorët. Shpirti i civilizimit Islamik, i cili e prodhoi dhe e dalloi civilizimin dhe kulturën në shekujt e fillimit dhe të lulëzimit. Vendi i defektit që e bëri civilizimin të mbetej prapa dhe që atrofizoi kulturën. Zgjidhja dhe dalja prej këtij qorrsoakaku civilizues në të cilin jeton sot Umeti islam.

01 BESIMTARËT MYSLIMANË FESTOJNË KURBAN BAJRAMIN



Besimtarët myslimanë në mbarë vendin tonë kanë nisur që në orët e para të mëngjesit të sotëm kremtimin e Festës së Kurban Bajramit, një ndër ditët më të rëndësishme të kalendarit islam.

Ceremonia qendrore e faljes së bajramit u zhvillua në bulevardin "Dëshmorët e Kombit" në Tiranë, ku u mbledhën mijëra besimtarë, ndërkohë që e njëjta situatë u paraqit në të gjitha qytetet e vendit, ku besimtarët mbushën sheshet dhe xhamitë kryesore për të kryer ritualin e faljes.

Programi i Kurban Bajramit nisi me leximin e disa ajeteve Kuranore nga hafizi Enes Hyka, duke i dhënë një atmosferë të thellë shpirtërore këtij momenti të veçantë.

Më pas, Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, mbajti fjalën përshëndetëse, ku uroi besimtarët myslimanë dhe të gjithë shqiptarët, brenda dhe jashtë vendit, për Festën e Kurban Bajramit, duke theksuar vlerat e solidaritetit, sakrificës dhe mëshirës që përcjell kjo ditë e begatë.

Më tej, ai bëri thirrje për më shumë reflektim mbi vlerat hyjnore në çdo punë apo përgjegjësi, publike apo private qoftë ajo..





Ceremonia u zhvillua më tej me ligjëratën e Nënkrjetarit të KMSH-së, z. Taulant Bica, i cili solli në vëmendje domethënien shpirtërore të kësaj feste dhe e lidhi kuptimin e Kurbanit me përpjekjen për t'u afruar me Allahun Fuqiptotë dhe për të ruajtur vlerat e pastra të besimit.

Programi kulmoi me faljen e namazit të Kurban Bajramit, ku mijëra besimtarëve të mbledhur në bulevard u priu Kryetari i KMSH-së, H. Bujar Spahiu.

Fill pas faljes së namazit, imami i xhamisë "Et'hem Bej", z. Elton Karaj, mbajti hutben e Bajramit, hutbe në të cilën trajtoi disa aspekte sociale të kësaj feste.

Në përfundim të programit, besimtarët e shumtë të mbledhur me këtë rast shkëmbyen mes tyre urimet më të përzemërta të kësaj dite të mbushur me paqe, dashuri, solidaritet dhe sakrificë.

Komuniteti Mysliman i Shqipërisë ju uron të gjithë shqiptarëve, kudo që jetojnë e punojnë: Gëzuar Kurban Bajramin!



02 KOLEGJI UNIVERSITAR "BEDËR" DIPLOMON BREZIN E 12-TË TË STUDENTËVE



Kolegji Universitar "Bedër", institucioni më i lartë arsimor i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, diplomoi brezin e 12-të të studentëve.

Në një ceremoni të zhvilluar me këtë rast, 220 studentë nga programe të ndryshme studimi të ciklit të parë dhe të dytë, hodhën në ajër kapelet e diplomimit, duke simbolizuar kështu përfundimin e rrugëtimit të tyre akademik.

Të pranishëm në këtë eveniment, ishin: Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, Rektori i KU "Bedër", Prof. Gjergj Sinani, trupa akademike e institucionit, përfaqësues të institucioneve partnere, personalitete si dhe familjarë të shumtë të studentëve.

Në fjalën e tij të rastit, Kryetari Spahiu theksoi rëndësinë strategjike të arsimit cilësor dhe rolit të pazëvendësueshëm që luan ky institucion në edukimin e brezave të rinj. Ai i përgëzoi studentët për përpjekjet e tyre dhe i inkurajoi që të vazhdojnë të kontribuojnë me dije, integritet dhe përgjegjshmëri në shërbim të shoqërisë shqiptare dhe më gjerë.

Në emër të institucionit, të diplomuarit u përshëndetën edhe nga Rektori, Prof. Gjergj Sinani, i cili i përgëzoi studentët për arritjen e këtij momenti të rëndësishëm në jetën e tyre dhe uroi që rruga e tyre e mëtejshme të jetë e mbushur me suksese dhe kontribute pozitive në shoqëri.

Diplomimi i brezit të dymbëdhjetë nga ky institucion përbën një dëshmi konkrete të misionit të Komunitetit Mysliman të Shqipërisë për të ndërtuar institucione arsimore moderne, me baza të forta etike e profesionale, në shërbim të shoqërisë tonë.



03 ZHVILLOHET MBLEDHJA E PËRBASHKËT ME ADMINISTRATORËT E RRETHEVE



Në kuadër të mbledhjeve periodike që u zhvilluan më herët me strukturat e institucionit në qendër dhe në rrethe, ditën e djeshme, u pritën në selinë e KMSH-së administratorët e qarqeve, me të cilët u diskutuan një sërë çështjesh kyçe për menaxhimin dhe përmirësimin e shërbimeve fetare dhe atyre administrative.

Në takim me ta, morën pjesë Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, Kancelari i institucionit, z. Fejzi Shaholli, Drejtori i Drejtorisë së Vakf-Investimeve, z. Erlis Moshë, si dhe drejtues të tjerë të sektorëve kryesorë, si financat apo çështjet juridike.

Në hapje të takimit, kryetari Spahiu vuri në dukje domosdoshmërinë e komunikimit të vazhdueshëm mes strukturave të institucionit, me qëllim rritjen e cilësisë së shërbimeve dhe përgjigjen sa më efektive ndaj nevojave të kohës.

Më tej, Drejtori i Vakf-Investimeve, z. Moshë, u ndal në një sërë çështjesh të ndryshme me ta, si: ecuria e anëtarësimeve vjetore, menaxhimi i vakëfeve aktuale dhe zhvillimi i vakëfeve të reja, zekati, raportet financiare, etj.

Në takimin me administratorët u diskutuan edhe çështjet juridike, si legalizimet dhe regjistrimi i pronave me vërtetim pronësie, ndjekja e dosjeve të ATP-së dhe proceseve të hapura gjyqësore, me qëllim mbrojtjen sa më efektive të interesave të institucionit.

Në fjalën e tyre, administratorët e qarqeve sollën në fokus problematika të ndryshme nga përditshmëria që hasin në terren, mbi të cilat u propozuan edhe zgjidhjet më efektive për çdo rast.

Ky takim u zhvillua më tej në formën e një bashkëbisedimi konstruktiv mbi përmirësimin e performancës së përgjithshme.



04 ZHVILLOHEN MBLEDHJET VJETORE ME MYFTINJTË E VENDIT



Zhvillohet ceremonia e nisjes së fazës së dytë të projektit "Në ndihmë të fëmijëve jetimë të Republikës së Shqipërisë" në ambientet e Medresesë Tiranë. Projekti, tashmë për të dytin vit radhazi, financohet nga Qendra Bamiëse "Mbreti Selman" dhe zbatohet nga Komuniteti Mysliman i Shqipërisë në bashkëpunim me Ambasadën e Mbretërisë së Arabisë Saudite në Tiranë.

Në ceremoninë e hapjes, morën pjesë: Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, Ambasadori i Mbretërisë së Arabisë Saudite në Tiranë, z. Fajsal Gazi Hifdhi, Nënkrjetari i KMSH-së, z. Lauren Luli, myftinj nga rrethet e ndryshme të vendit ku shtrihet projekti, si dhe familjarë dhe fëmijë përfitues.

Në fjalën e tij përshëndetëse, kryetari Spahiu shprehu vlerësimin për vazhdimësinë e këtij bashkëpunimi me qendrën "Mbreti Selman". Ai theksoi se për KMSH-në është nder të jetë partner kryesor në mbështetjen e 150 fëmijëve jetimë në 10 rrethet e ndryshme të vendit.

Ndërsa Ambasadori Hifdhi përshëndeti të pranishmit dhe theksoi se mbështetjet e kësaj natyre janë shprehje e vizionit humanitar të mbretit Selman.

Po ashtu, në emër të familjarëve dhe fëmijëve përfitues të këtij projekti, ndanë përshtypjet e tyre një nënë dhe një fëmijë i pranishëm në aktivitetin inaugurues. Ata u shprehën se ndihma financiare mujore ka qenë një lehtësim i madh për familjen, sidomos për përballimin e nevojave bazë të fëmijëve si ushqimi, veshmbathja apo shkolla. Në përfundim të ceremonisë, u shpërndanë në mënyrë simbolike mbështetjet financiare mujore për muajin Maj.





Mbledhja u çel me leximin e disa ajeteve kuranore nga Drejtori i Arsimit në KMSH dhe njëherazi imami i xhamisë “Et’hem Bej” në Tiranë, z. Elton Karaj, për të vijuar me fjalën hapëse të Kryetarit të Këshillit të Përgjithshëm të Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, z. Islam Hoxha.

Më tej, fjalën e mori Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, i cili shprehu mirënjohjen e tij për të gjithë anëtarët e pranishëm, duke vlerësuar kontributin e tyre të çmuar në mbarrëvajtjen e veprimtarisë institucionale. Ai prezantoi një përmbledhje gjithëpërfshirëse të aktiviteteve më të rëndësishme të Komunitetit Mysliman që nga mbledhja e fundit, duke evidentuar arritjet më të spikatura, projektet e realizuara, si dhe sfidat me të cilat është përballur institucioni në përmbushjen e misionit të tij fetar, arsimor dhe shoqëror. Mbledhja vijoi me prezantimin e raportit të Kryesisë së Këshillit të Përgjithshëm, nga z. Islam Hoxha, i cili këtë herë u ndal në ecurinë e aktiviteteve fetare dhe administrative të Myftinisë Pogradec, duke ofruar një pasqyrë të qartë dhe të strukturuar mbi punën e kryer gjatë periudhës në shqyrtim.

Në vijim të mbledhjes, Kancelari i institucionit, z. Fejzi Shaholli, prezantoi një raport të hollësishëm mbi veprimtaritë e Kryetarit Spahiu, aktivitetin e drejtorive dhe vendimet e Kryesisë të ndërmarra që nga mbledhja e fundit. Një nga pikat kryesore të kësaj mbledhjeje ishte prezantimi i platformës më të re online nga Drejtori i Drejtorisë së Vakf-Investimeve, z. Erlis Moshë. Në fjalën e tij, z. Moshë bëri një paraqitje të detajuar të kësaj platforme inovative, e cila mundëson akses të hapur për publikun, duke i lejuar qytetarët dhe donatorët të informohen në kohë reale mbi ecurinë e projekteve në zhvillim, si dhe të kontribuojnë financiarisht në mënyrë të drejtpërdrejtë për realizimin e tyre.



NJË BURRË, NJË GRUA NË ZEMËR TË MODERNITETIT

Një burrë, një grua në zemër të modernitetit. Nëse do të përqendroheshim në botën tonë dhe do ta kuptonim atë, ajo do të na shfaqej gjithnjë e më e izoluar. Ditët kalojnë dhe vërtetojnë gjithnjë e më shumë lajthitjen e njeriut. I sjellë deri këtu nga teknika dhe zhurma, ai ndërton jetën e tij bazuar mbi shpejtësinë, shkencat kompjuterike, muzikën dhe kinemanë.

I tejngarkuar nga uria dhe lodhja, heshtazi ai ngre mbijetesën e vet bazuar mbi pritshmëritë dhe shpresat.

Kohët moderne do të mbartin për kujtimet tona interesin për imazhin dhe neglizhencën e pafundme të realitetit dhe kuptimit.

Në lindje sikundër edhe në perëndim, epoka jonë buron urinë më të tmerrshme që ka ekzistuar ndonjëherë mbi tokë. Trupat e

torturuar kumbojnë vuajtjet e mendjeve... trupat dhe zemrat të etura për pak njerëzi. Varfëria, hallakatja, diktatura dhe luftërat, çdo ditë e më shumë i zënë frymën dinjitetit të miliona njerëzve, burra dhe gra, dhe nuk e lejojnë atë të gjejë shprehje lirshëm. Vetmia, individualizmi, mjerimi moral, mungesa e dashurisë ushqehet me qenien e gjithë atyre të cilëve rehatia do të duhej t'u kishte dhuruar edhe kënaqësinë.

Ku është rruga? Ku jemi duke shkuar ne?

Si mund të jesh një burrë... si mund të jesh një grua sot? Gjendur në bërthamën e kësaj agonie, si jemi ne duke iu përgjigjur zemrave tona dhe si jemi duke e mbrojtur dimensionin tonë shpirtëror? Në humnerën e kaq shumë disekuilibrave, si jemi ne duke përçuar atë ekuilibër dhe harmoni që zemrave tona do t'u japë qetësinë?



Si mbetemi ne besimtarë, besnikë ndaj paktit të origjinës, ndërsa modernizmi na kthen në kaq mosbesues ndaj të qenit njeri?

Kujtimi i agimit të parë: **"Përkujto kur Zoti yt, nxori nga shpina e bijve të Ademit, pasardhësit e tyre dhe i bëri dëshmuës të vetes së tyre (duke u thënë): "A nuk jam Unë Zoti juaj?". Ata thanë: "Po, dëshmuam"... (Kur'ani, 7: 172)**

Kjo dëshmi jeton në thellësitë e zemrave tona; na flet dhe na bën thirrje. Zemra jonë është shpresa jonë; shpirti ynë është rruga jonë:

"...se në të vërtetë sytë nuk verbohën, por verbohën zemrat në kraharorë..." (Kur'ani, 22:46)

Kjo do të thotë të shohësh në thellësitë e vetvetes, sepse zotëron fuqinë e shikimit,

shikimit të vërtetë. Do të thotë të jesh me Zotin tënd duke lexuar shenjat e Tij. Të jetosh me përkujtimin e Tij për të mbushur veten me nënshtrimin ndaj Tij, për t'i dhënë natës dritën e saj dhe për t'u lutur fuqishëm në heshtjen e pafund.

"Ne do të shpallim ty një fjalë të rëndë. E s'ka dyshim se veprimi i natës është fuqizues dhe fjalë më e qartë. Vërtet, ti gjatë ditës ke angazhim të gjatë. Por ti përmende Zotin tënd dhe plotësisht përkushtoj Atij. Zoti i lindjes dhe i perëndimit, nuk ka zot tjetër vetëm Ai, pra Atë merre për mbështetje." (Kur'ani, 73: 5-9)

Është kaq e vështirë t'i japësh jetë zemrës tënde. Vrapi i përditshëm i botës na largon nga vetja në atë pikë sa shpesh e thyen më dysh

personalitetin tonë duke na grisur në qindra copëra. E kam këtë kujtim kaq të afërt në sytë e mi: një imazh nga Tunizia, Egjipti, India ... pastaj Amerika, Europa... e kam në Lindje sikundër e kam në Perëndim, e kam të premtëve ashtu edhe në të gjithë ditët e tjera të javës: copëtimi i botës islame është aty.

Populli, komuniteti, dëshirat, shpresat dhe qëllimet më të mira. Dita më e bukur e javës, dita e të gjitha simboleve.

Rituali - përkujtim mbi kuptimin, sytë e lagur, lotët e zemrës. Bota islame vlon në këtë fillim të shekullit të njëzetë e një, ashtu sikundër vlonte dikur, në fillim të shekullit të shtatë. Zoti është dëshmitar për këtë forcë besimi. Xhamitë hapen, rrugët kthehen në xhami, i gjithë globi është një xhami. Umeti është këtu; i pasuri dhe i varfri, shkencëtari kompjuterist dhe analfabeti, dëshmitarë të së njëjtës dëshmi, duke kërkuar të shuajnë të njëjtën etje.

E shtunë, e diel dhe çfarë pason. Pesë orë të mëngjesit, pasdites, apo edhe katër. Gjumi është kaq i rëndë, puna kaq preokupuese. Kaq shumë heshtje të premtëve dhe kaq shumë fjalë në ditët që pasojnë. Kaq shumë vërtetësi dhe pastaj kaq shumë gënjeshtër, kaq shumë shpresa dhe pastaj kaq shumë ankime, kaq shumë dëshirë dhe pastaj kaq shumë apati. Kishte këtu një kujtim, ajo që mbeti është harresa. Kishte kaq shumë këtu, por mbeti kaq pak. Gjatë ditëve të javës, jeta e përditshme gjen justifikimet e saj që kthehen në arsye për besimin tonë. Epoka jonë është një torturë. Dimension i ynë shpirtëror është sprovë jonë.

Të premtëve, sikundër edhe në ditët e tjera të javës, plagët tona janë të thella.

Ka disa të cilët, të shtyrë nga egoizmi i kësaj bote, përshtatin një mënyrë jete mistike. Larg nga bota, ambiciet dhe konfliktet; të ushqyer nga drita e të vetmes Dritë. Në perëndim ka qenë konsideruar se ky ishte "Islami i vërtetë", "Islami tjetër", ai që të imponon respekt, përderisa është një Islam që sulmon mendjet. Dikush duhet të jetojë larg, që të jetojë më mirë; të braktisë njerëzit në mënyrë që t'i afrohet Zotit më shumë. Epoka Mistikët, me anë të meditimit të tyre, veçimit të tyre të brendshëm, dhe evitimit të botës kanë ndjekur dhe janë duke ndjekur shembullin e Profetit a.s., i cili shpenzonte net të tëra në falje e meditim, duke kthjelluar kujtimin e tij, duke thelluar mirënjohjen e tij dhe duke perfeksionuar adhurimin ndaj Tij. Lotët e derdhur nga meditimi bëjnë të dukshme shenjat në univers. Prania e të shenjtës shpallet:

"Në krijimin e qiejve dhe të tokës, në ndryshimin e natës dhe të ditës, ka argumente të qarta për ata që kanë arsye dhe intelekt. Për ata që Allahun e përmendin me përkujtim kur janë në këmbë, kur janë ulur, kur janë të shtrirë, dhe thellohen në mendime rreth krijimit të qiejve dhe të tokës (duke thënë): "Zoti ynë, këtë nuk e krijoje kot, i Lartësuar qofsh, ruana prej dënimit të zjarrit!" (Kur'ani, 3:190-191)

Në zemër të ekzistencës sonë të përditshme, e cila përpëllitet dhe pastaj mbytet në preokupimet më të mbingarkuara, kjo është e barabartë me hedhjen e një hapi pas, me mërgimin e vetes në qendrën e saj, me kërkesën për forcimin e kujtimit të saj, dashurinë dhe njohjen, falënderimin dhe faljen në mes të zhurmës, në kërkim të qetësisë dhe jetës së mbushur me kuptimin e fjalëve:

"Jeto në këtë botë si një i huaj ose si një kalimtar."

Ky dimension shpirtëror me kërkesat që ai shtron, është në zemër të jetës sonë të përditshme. Çështja është të mos mohojmë asgjë nga qenia jonë, as trupin tonë, as shpirtin tonë, as këtë jetë dhe as jetën që pason. Sprova e shpirtit është një sprovë ekuilibri, nuk është tjetër veçse "rruga e mesme", ashtu sikundër është edhe rruga e të gjitha vështirësive. Disa nuk duan tjetër veçse jetën e kësaj bote, dhe kështu që ata e humbin veten:

"Ka disa prej njerëzve që thonë: "Zoti ynë na jep Ti neve në këtë botë". Për të tillët nuk do të ketë asgjë në botën tjetër." (Kur'ani, 2:200)

Të tjerë, për aq sa u lejon humanizmi i tyre, duan të jenë këtu që të jenë mirë atje:

"E ka prej tyre asish që thonë: "Zoti ynë na jep të mira në këtë jetë, të mira edhe në jetën tjetër dhe na ruaj prej dënimit të zjarrit." (Kur'ani, 2:201)

Kjo do të thotë të jetosh jetën tënde të përditshme duke punuar dhe duke formuar vetveten; do të thotë të testosh besimin tënd me veprimet e tua, zemërimet, iluzionet, do të thotë të jesh me Zotin edhe kur je me njerëzit, dhe t'i japësh asaj që njeriu ka, kuptimin e asaj që ai është:

"Dhe me atë që të ka dhënë Allahu përpiku ta fitosh botën tjetër, e mos le mangët atë që të takon nga kjo botë, dhe bëj mirë sikundër të ka bërë Allahu ty, e mos bëj të këqija në tokë se Allahu nuk i do çrregulluesit." (Kur'ani, 28:77)

Kjo do të thotë të jesh me gjithë qenien tënde në këtë botë, duke mbartur dëshminë e besimit tënd nëpërmjet veprimeve të drejta dhe të mira.

Pra të mos refuzosh asgjë nga ajo që njeriu është, në mënyrë që të jetosh me qenien tënde të plotë.

“Më i miri nga njerëzit është ai i cili është më i dobishmi ndaj tyre.”

Tashmë epoka jonë na sfidon. Shoqëria e zbavitjes, shoqëria e konsumit të tejskajshëm, individualizmit të përgjithësuar bashkë-ekziston me varfërinë dhe mjerimin më total. Përballë këtyre fataliteteve, ku qëndron kuptimi? Mbushur me përkujtimin e Zotit, përgjatë gjithë këtij modernizmi, në cillin burim do të mund ta shuajmë ne etjen tonë? Çdo njeri e njeh humbjen më të madhe të kësaj jete, e cila vret diçka brenda nesh: qëndrimi ulur përpara televizionit, të abuzuar nga një rrymë e fuqishme informacioni dhe të paralizuar nga qëllimi i fraksioneve. Pra të kesh gjetur Zotin, por të jetosh i vdekur. Do të thotë të humbësh mendjen tënde, sepse dikush ka humbur zemrën e tij.

Dikush mbase duhet të jetojë të kotën që të mësojë si të jetë një burrë, si të jetë një grua, në pasqyrën e koshiencës së tij dhe në sytë e atyre që e rrethojnë. Dikush dëshiron kaq shumë të gjejë forcën t’u japë bukuri mendimeve të tij dhe të pastrojë zemrën e tij. Është shpresa dhe pritshmëria e gjithsecilit të jetojë në qetësi dhe të hedhë hapat e tij në qartësi. Në zemër të gjithë këtij modernizmi, pëllëmbët e duarve, durueshëm, drejtohen drejt qiellit.

Një burrë, një grua është thjesht një pyetje ekzistence. Të bëhesh një njeri i mirë dhe të bësh mirë. Cili burrë nuk ka dëshiruar të jetë për partneren e tij një horizont i pritshmërive të saj, të ecë me të në të njëjtin breg dhe nga përkujdesja dhe falja ta kthejnë bashkimin e tyre në një shenjë. Një çift i cili është për njerëzimin ajo çka dielli është për natyrën: ngrohtësi dhe shenjë e Krijimit.

Në zemër e këtij modernizmi, cila grua nuk ka dëshiruar, me të njëjtin qëllim, të jetë për bashkëshortin e saj energjia e rrugës së tij?

Cila nënë, cili baba, cili prind nuk ka shpresuar për fëmijët e tij mjedisin më harmonik, familjen më unike, dhe më të madhen forcë çliruese? Cili nuk ka dëshiruar të shohë qoftë edhe një herë në sytë e vajzës apo djalit të tij, në thellësi të zemrave të tyre, shkëlqimin që jep falënderimi dhe bindja, të cilat përbëjnë besimin? Në zemër të këtij modernizmi, cili bir apo bijë nuk ka dëshiruar të jetojë midis dy qenieve, i rrethuar nga dashuria e tyre, i ushqyer me vlerat e tyre dhe i fuqizuar nga uniteti i tyre?

Gjëra kaq të thjeshta janë kaq shqetësuese

në epokën tonë. Të jesh i mirë dhe të bësh mirë, i gjendur përpara Zotit, ky është kuptimi i kësaj thirrje, kënduar më shumë se 17 herë në ditë, si dje ashtu edhe sot, në zemër të këtij modernizmi:

“Udhëhiqna në rrugën e drejtë!” (Fatiha, 6)

Të ecësh në rrugën e drejtë, rrugën e mesit të drejtë, për të përkujtuar Zotin dhe për të ruajtur në zemrat tona ndjenjën e vlerave dhe finaliteteve. Gjithmonë duke ecur përgjatë saj pavarësisht nga rreziqet dhe kundërshtitë, pavarësisht nga padrejtësitë dhe tmerret, duke besuar Zotin ashtu që të mos dëshpërohesh nga njerëzit dhe ngjarjet. Të ecësh përgjatë saj, sërish e sërish, thjesht një përpjekje për të qenë një burrë dhe një përpjekje për të qenë një grua. Në kthjelltësi dhe qartësi duke pranuar dobësitë vetjake dhe qenien tënde njerëzore, duke gjetur në zemrën e namazit forcën për nënshtrim. Të jesh i nënshtruar dhe përkujtues i gjendur në zemër të modernizmit:

“Ti përmende Zotin tënd heshtaz, me respekt dhe me drojë, jo me shprehje të larta, (përmende) në mëngjes e në mbrëmje dhe mos u bëj prej atyre që nuk kanë kujdes. S’ka dyshim se ata që janë pranë Zotit tënd (engjëjt) nuk tërhiqen prej adhurimit të Tij nga mendjemadhësia. Atë e madhërojnë dhe vetëm Atij i bëjnë sexhde.” (Kur’ani, 7: 205-206)

Dhe e gjithë kjo duke u përballuar me të gjitha llojet e individualizmit njerëzor, të gjithë reflekset e konsumit, të gjithë iluzionet televizive e kinematografike dhe të gjithë neglizhencat. Duke refuzuar të gjithë padrejtësitë, në opozitë me të gjithë llojet e shfrytëzimit, duke luftuar kundër të gjithë poshtërsive. Duke thënë dhe ruajtur fuqishëm forcën e nënshtrimit dhe besimit në Zot, pafundësisht gjithmonë. Duke gjetur rrugët për veprim; duke armatosur veten me dritë nëpërmjet durimit. Në vëllazërinë e njerëzve kundër shoqërisë së individëve, në bashkimin e lirisë kundër egoizmit të varësisë. Në zemër të modernizmit, rruga e drejtë: dimensionin ynë shpirtëror, në zemrat tona, qëndron në qendër të jetës.

Duke refuzuar neglizhencat dhe duke dëgjuar, duke dëgjuar thellë, përtej heshtjeve të kohërave, duke dëgjuar dhe duke mbajtur vesh, zërin e skllavit të dikurshëm, Bilalit që thërret besimtarët në besimin e tyre, pesë herë në ditë, përjetësisht... Duke kërkuar në jehonën e këtij zëri dhe në ritmin e faljeve, duke kërkuar dhe gjetur drejtimin e rrugën, në zemër të modernizmit.

Etika e Xhumasë



يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا إِذَا نُودِيَ لِلصَّلَاةِ مِنْ يَوْمِ الْجُمُعَةِ فَاسْعَوْا إِلَىٰ ذِكْرِ اللَّهِ وَذَرُوا الْبَيْعَ ذَلِكُمْ خَيْرٌ لَّكُمْ إِنْ كُنْتُمْ تَعْلَمُونَ

“O besimtarë, kur të thirrreni për (të falur) namazin (e xhumasë) në ditën e premte, nxitoni për ta përmendur Allahun dhe pezulloni tregtinë! Kjo, që ta dini, është më mirë për ju!” (Xhumua, 62/9)

Lexues të nderuar, besimtarë e besimtare.

Dita e xhuma, dita më e mirë dhe më me bereqet e javës. Sot është ditë gëzimi për besimtarët, ditë në të cilën grumbullohemi së bashku. Xhumaja nga aspekti fetar është sepse për të fituar mëshirën dhe faljen hyjnore, nga aspekti social është një mundësi për të mbajtur gjallë vëllazërinë dhe për ta forcuar atë. Kjo përzjerje e cilësive të ditës së xhuma, bën që të gjendemi në një atmosferë shpirtërore ndryshe nga ditët e tjera të javës. Dhe Profeti (a.s) ka thënë kështu për xhumanë: **“Dita më e mirë në të cilën lind dielli është e xhumaja. Ademi (a.s) u krijua dhe hyri në xhenet në këtë ditë, po ashtu edhe dalja u realizua të xhuma.”**Pra edhe shkelja për herë të parë e njeriut në tokë ka ndodhur të xhuma.

Vijon Profeti (a.s) duke thënë: “Edhe dita e kiametit do të ndodhë ditën e xhuma”. (Muslim, Xhumua, 18)

Ditët e gëzimit për myslimanët, janë njëkohësisht ditë adhurimi. Vepra më e rëndësishme që mund të kryejmë sot, është falja e namazit të xhumasë. Xhumaja është farz për meshkujt, rrjedhimisht një nga përgjegjësitë më të mëdha, përgjegjësi e nivelit më të lartë. Allahu i Madhëruar na e ka shpallur këtë detyrë nëpërmjet Librit të Tij, pikërisht në suren Xhumua ku thotë:

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا إِذَا نُودِيَ لِلصَّلَاةِ مِنْ يَوْمِ الْجُمُعَةِ فَاسْعَوْا إِلَىٰ ذِكْرِ اللَّهِ وَذَرُوا الْبَيْعَ ذَلِكُمْ خَيْرٌ لَّكُمْ إِنْ كُنْتُمْ تَعْلَمُونَ

Aq me vlerë është për Allahun ky namaz, saqë e ka urdhëruar në mënyrë të drejtpërdrejtë. Prandaj braktisja e namazit të xhumasë pa kurrfarë shkakut të qenësishëm është gabim i rëndë. Profeti (a.s) na ka tërhequr vëmendjen në këtë formë: **“Personit që për shkak të indiferentizmit, braktis tre here rresht namazin e xhumasë, i vulozet zemra”. (Ibn Mâxhe, Ikâmet, 93)**

Çdo besimtar që dëshiron të përfitojë prej bereqetit dhe mirësive të xhumasë, bën përgatitje sipas Sunetit të Profetit Muhamed (a.s). Ai, para se të dalë nga shtëpia, bën pastrimin material dhe shpirtëror, duke u larë dhe duke marrë abdes. Përkujdeset që rroba e tij të jetë e pastër, si dhe në përshtatshmëri me kriteret e nevojshme për faljen e namazit, që janë mbulimi i detyrueshëm i trupit. Siç dihet, pastërtia materiale dhe shpirtërore, si dhe veshja që mbulon pjesë të caktuara të trupit të njeriut, janë prej kushteve jo vetëm të namazit të xhumasë, por edhe të çdo namazi tjetër. Përtej burrave, kjo çështje kërkon një përkujdesje edhe më të madhe tek motrat tona myslimane.

Të përdorësh parfum është sunet i Profetit (a.s), është edhe sunet i xhumasë.

Besimtari që niset për në xhuma, bën kujdes edhe në veprimet e tij. Di që gjendet në xhemat të xhamisë dhe sillet në përshtatshmëri me ambientin. Kur hyn në xhami, nëse s'ka nisur hytbja, përshëndet me selam besimtarët, gjen një vend të përshtatshëm dhe pa shqetësuar të tjerët ulet në vendin e tij. Sajë të respektit ndaj xhumasë, përpiket të shmangë veprime, që mund tërheqin vëmendjen e të tjerëve dhe merret me adhurime, si këndimi i Kuranit, dhikri apo dua. Nëse është në 45 minutëshin para ezanit, duhet të ketë parasysh, që është e papëlqyeshme të falesh kur dielli është duke arritur kupolën e qiellit, duke qene se ky ishte një nga momentet që mexhunitë, adhuruesit e zjarrit, i faleshin diellit.

Pasi nis ezani, tashmë çdo vepër tjetër e personave që janë në punët e tyre të përditshme, ndalon. Tregëtia, bisedat e ndryshme, e çfarëdolloj pune tjetër lihet përgjysmë pa shkakuar dëme dhe besimtari i drejtohet xhamisë. Pas ezanit në ambientet e xhamisë ka vetëm namaz dhe heshtje. Falen sunetet e xhumasë dhe pritët ezani i dytë. Këto momente mund të shfrytëzohen edhe me dua.

Kurse pas ezanit të dytë, nis hytbja e xhumasë. Hytbja është ligjërimi nga minberi drejtuar ymetit. Është këshillë për çdo besimtar, edhe për vetë ligjëruetin. Është thirrje në besim, në njohjen e Allahut, në vlerat e larta islame, në normat e moralit, është thirrje në të vërtetat më të larta, që ekzistojnë.

Hytbja është një prej deyrimeve të xhumasë. Është adhurim, ashtu siç është vetë namazi. Hoxha ka detyrimin ta ligjërojë, xhemati ka detyrimin ta dëgjojë. Prandaj dëgjimi me kujdes i hytbes është vaxhib, pra detyrim fetar. Të merresh me punë të tjera gjatë hytbes, si psh t'i flasësh personit në krah, të luash me telefonin, të merresh me rrobat që ke veshur, etj, do të thotë të largohesh nga hytbja dhe të privohesh prej sevapeve të mëdha që kjo ditë na mundëson një herë në javë. Profeti

(a.s) ka thënë: "Është e gabuar qoftë t'i thuash "hesht" shokut që po flet gjatë hytbes". (Muslim, Xhumua, 11)

Krahas kësaj, edhe ligjërueti duhet të bëjë kujdes, që hytbet të mos jenë shumë të gjata, përndryshe pamundësohet përqendrimi i njeriut. Koha maksimale që njeriu mund të qendrojë i përqendur është rreth 20 minuta. Pastaj, edhe po të përpiket, e ka të vështirë. Me sa duket, Profeti ynë (a.s) e dinte shumë mirë këtë, duke qenë se hytbet e tij zgjasnin 5 deri në maksimumi 20 minuta.

Për të ruajtur bereqetin e xhumasë nevojitet që gjithkush të kontribuojë me sjelljet e tij, sepse në të kundërt, kjo do të kthehet në një mundësi të humbur. Përqendrimi ynë gjatë xhumasë duhet të jetë vetëm tek adhurimi dhe sidomos tek dua. Kjo, për arritur dhe një gëzim tjetër që Profeti (a.s) na ka treguar me këto fjalë të bekuara: "Ditën e xhuma, ka një moment, ku Allahu pranon çdo gjë që robi atij i kërkon". (Tirmidhi, Xhumua, 2)

Le të bëjmë përpjekje që të marrim sa më shumë dobi nga kjo ditë e bekuar. Të ndjekim me përkushtim udhëzimet e Profetit Muhamed (a.s) dhe të respektojmë vlerat që na mëson Islami. Le ta mbushim zemrën me dashuri për Allahun, për Profetin tonë dhe për njëritjetrin. Le të jemi falënderues për mundësinë që na është dhënë të mblidhemi në këtë xhuma, sepse çdo frymëmarrje dhe çdo moment i shpenzuar në adhurim është një thesar për jetën tonë të përjetshme.

Allahu na bëftë prej atyre që e kuptojnë vlerën e kësaj dite, që e falin xhumanë me përkushtim dhe që e mbushin jetën me vepra të mira. Allahu na dhëntë të gjithëve udhëzim, mëshirë dhe falje!



MËNYRA E DEBATIT DHE KOMUNIKIMI NË FAMILJE



Prej faktorëve që e pengojnë komunikimin brenda familjes në ditët e sotme janë edhe polemikat e kota e pavlerë. Debati, pavarësisht se në plan të parë mund të duket jo i dëmshëm dhe i logjikshëm apo si një faktor i pazëvendësueshëm i komunikimit, nëse nuk zhvillohet komfort rregullave, me kalimin e kohës mund ta zbehtë dashurinë dhe respektin për sho-shoqin. Fatkeqësisht në shumë raste duke qenë se kjo situatë nuk kalohet me sukses, debati më tepër se dobi, sjell dëme. Kështu që, çiftet që pretendojnë të kenë komunikim më të frytshëm duke debatuar, me kalimin e kohës ftohen dhe largohen nga njëri-tjetrit. Me kalimin e kohës duke mos e vënë re dëmin që i sjell debati atyre dhe familjes, bashkëshortët fillojnë të kërkojnë fajtorë të tjerë duke pyetur “Mos vallë na ka bërë dikush magji?” apo “Mos e kanë marrë nazar marrëdhënien tonë?”. Në fakt, faji nuk është jashtë, është brenda, dhe pikërisht ata vetë janë fajtorët. Ajo që nuk njih asnjë parim në debat apo edhe pse i njeh i lë mënjanë, është egoja e njeriut.

Që debati apo diskutimi të japë frytet të cilat priten prej tij dhe që të ruhem prej dëmeve të tij, duhen ndjekur disa parime të cilat mund t'i shtjellojmë si më poshtë:

Vetëdija që vendimi i fundit do të jepet para Allahut

Si në çështjet familjare apo edhe në çështje të tjera jashtë saj, diskutimet duhen bërë me ndjenjën e ihsanit (të veprosh sikur e sheh Allahun, edhe pse nuk e sheh Ai të shikon ty). Sepse Allahu mbikëqyr çdo situatë të robërve të Tij. Çdo çështje për të cilën debatohet, çdo çështje që nuk ka dakordësi midis palëve do të sillet në praninë e Allahut (xh.sh) ditën e kiametit. “Me të vërtetë, ti do të vdesësh, e me të vërtetë edhe ata do të vdesin. E pastaj, në Ditën e gjykimit, te Zoti juaj do të polemizoni.”¹ Kur zbret ky ajet, Zubejr b. Avam (r.a) e pyet të Dërguarin e Allahut (s.a.s.):

– O i Dërguari i Allahut, çështjet që kemi diskutuar në këtë botë, polemikat e debatet ndryshme, a përsëriten sërish ditën e kiametit?

– Po,- i thotë i Dërguari i Allahut.

– Atëherë, situata qenka shumë e vështirë,²-thotë Zubejr b. Avam (r.a). Kështu që, duhet pasur kujdes që kur debatojmë rreth një çështjeje mos të sillemi egoist për të mbrojtur pretendimin tonë, pa parë se si është e vërteta. Të mos shkojmë në botën tjetër me cënime të

1. Surja Zumer, 30-31

2. Tirmidhi, Tefsir 40; Ahmed b. Hanbel, Musned, III/21



të drejtave të të tjerëve pa e vënë re.

Në të kundërt, kushdo që flet, flet pa ndjerë asnjë lloj përgjegjësie dhe e dëmton komunikim. Kurani famëlartë duke na paraqitur një shembull nga epoka e lumturisë, na jep një shembull të vyer në këtë çështje:

Eus b. Samit, që ishte nga ensarët, një ditë nxehet me gruan e tij, Haule b. Salebe dhe i thotë: "Shpina jote është për mua si shpina e nënës time". Pa kaluar shumë, ai bëhet pishman për këtë veprim. Por, Haule nuk mund ta pranonte këtë krahasim, i cili binte ndesh me traditën e asaj kohe. Ky krahasim në atë kohë nuk kishte kuptim tjetër veç divorcit. Ajo nuk donte që t'i shkatërrohej foleja familjare. Si përfundim e gjen zgjidhjen duke ia treguar të Dërguarit të Allahun ngjarjen me të gjitha detajet e saj. Ajo u shpreh se e kishte kaluar rininë në shërbim të burrit të saj, i kishte dhënë shumë fëmijë atij, dhe se kërkonte që Profeti (s.a.s.) t'i gjente një zgjidhje për të mos u ndarë nga burri pas krahasimit që ai kishte bërë, krahasim ky që në atë kohë ishte i ekuivalent me divorcin. Profeti (s.a.s.) i thotë që gjykimi për këtë çështje vazhdon të jetë i njëjtë dhe që nuk ka zbritur revelatë e re për këtë çështje. Haule këmbënguli shumë për të treguar se sa e rëndë ishte situatë për të, por nuk arriti ta merrte përgjigjen që priste.

Kur e kuptoi që këmbëngulja nuk kishte ndonjë dobi, u tërhoq në një cep dhe filloi t'i lutet Allahut: "Zoti imi! Jam shumë e vetmuar. Kjo ndarje më bën të vuaj së tepërmi. Kam fëmijë të vegjël, nëse i lë që të jetojnë me të atin e tyre do të vuajnë shumë, nëse i marr unë do të vuajnë urie. Po ta paraqes Ty gjendjen time. Më shpëto nga kjo vështirësi. Zbriti një revelatë të Dërguarit tënd!" Pak pasi Haule e përfundoi duanë, filloi të zbriste një ajet. Profeti (s.a.s.) e thërret Haulen, i lexon asaj ajetin e zbritur dhe e përgëzon që martese e saj vazhdon akoma.³

Ajetet e zbritura për këtë çështje janë: "Vërtet Allahu i dëgjoi fjalët e asaj që bisedoi me Ty për burrin e vet dhe që iu ankua Allahut. Allahu dëgjon bisedat tuaja. Se, Allahu, me të vërtetë, i dëgjon dhe i sheh të gjitha."⁴

Aishja (r.a) e cila ishte dëshmitare e kësaj ngjarjeje duke thënë: "Sa i lartë është Allahu që dëgjon çdo zë! Ajo zonja kur po i paraqiste gjendjen e saj Allahut, fliste me aq zë të ulët sa ishte pamundur ta dëgjoje një pjesë të fjalëve të saj."⁵, në fakt me këto fjalë ajo (r.a) po interpretonte ajetin e parë ku Allahu thotë:

3. Ebu Davud, Talak 7

4. Shk. Surja Muxhadele, 1-5

5. Kurtubi, el-Xhami' li-Ahkami'l-Kuran, IX/6440

"Allahu, me të vërtetë, i dëgjon dhe i sheh të gjitha."

Për rrjedhojë, ata që mendojnë se nuk i dëgjon njeri kur debatojnë mes tyre, nuk duhet ta harrojnë asnjëherë faktin që Allahu dëgjon çdo gjë në çdo çast. Kjo do t'i kursejë atyre shumë fjalë të padrejta e sjellje të pahijshme.

Çështja duhet paraqitur Allahut (xh.sh) dhe Profetit (s.a.s)

Një çështje që diskutohet brenda familjes, duhet para nëse është në Kuran apo në thëniet profetike. Nëse çështja gjen zgjidhje aty, duhet braktisur debati për të mos dëmtuar marrëdhëniet familjare dhe duhet parë si parashtrohet në Kuran apo në traditën profetike. Urdhri i Kuranit drejtuar besimtarëve është i qartë në këtë çështje: "Betohem në Zotin tënd, se ata nuk do të jenë besimtarë të vërtetë, përderisa mos të marrin ty për gjykatës, për ato konflikte që ekzistojnë ne mes tyre; e pastaj, të mos ndiejnë kurrfarë dëshpërime ndaj gjyqimit tënd dhe të të binden ty plotësisht."⁶Kështu që, për një çështje që nuk biem dakord edhe pse kemi mendimin tonë, çështja duhet t'i parashtrohet Kuranin dhe traditës profeti, duhet t'i dorëzohemi gjyqimit të Kuranit dhe sytnetit.

Nuk duhet të mbytemi në debat, duhet t'i dorëzohemi të vërtetës

Gjatë debateve, në të shumtën e rasteve njeriu nuk e ruan dot gjakftohësinë dhe duke menduar që "duhet të dal fitimtar në çfarëdo lloj forme", pa e parë nëse informacioni është i saktë apo i gabuar e përdor si argument dhe mundohet t'ia mbyllë gojën bashkëbiseduesit apo ta mundë atë. Ata që debatojnë një çështje mes tyre, duhet të kenë kujdes këtë detaj, nuk duhet ta kalojnë kufirin në debat dhe nuk duhet të mbyten në egon e tyre. Profeti ynë (s.a.s.) i tërheq vërejtjen popullit të tij në këtë çështje dhe thotë: "Atë që e urren më shumë Allahu, është ai që gjatë debatit (për të dalë fitimtar, devijon nga e drejta) vazhdon debatin në

mënyrë të ashpër."⁷ Për rrjedhojë, principi që duhet ndjekur në debat nuk është triumfi, por kërkimi i së vërtetës së bashku. Në të kundërt, nëse nuk ruhet ky princip dhe vazhdon debati, nuk përftohet ndonjë dobi nga ky debat dhe merr gjynahe të shumta sipas shprehjes së Profetit (s.a.s.): "Njeriut i mjafton si gjynah (edhe pse e di që nuk ka të drejtë) ta vazhdojë debatin."⁸Në situata të tilla, bashkëshortët pa qenë të vetëdijshëm ashtu siç e humbasin sho-shoqin në këtë botë, duke u futur në gjynahe bëjnë që të humbasin edhe në jetën e pasme. Për rrjedhojë, rruga për të fituar këtu dhe në jetën e pasme është të mos të këmbëngulësh në gabim dhe kur e drejta del në pah ta pranosh atë, nëse është nevoja t'i kërkosh falje atij që ka të drejtë apo nëse është cënuar e drejta e robit t'i kërkohet që t'ia bëj hallall.

Në debat esencial është pajtimi

Kur debatohen çështjet brenda familjes, një prej pikave që duhen pasur kujdes është edhe pajtimi. Masa që na jep Kurani në debat, veçanërisht në ato familjare është edhe principi: "Pajtimi është më i dobishmi."⁹ Bashkëshortët kur debatojnë rreth diçkaje, duhet të kenë si qëllim që të bashkohen në një pikë, edhe nëse nuk e arrijnë dot këtë, duhet t'i lenë gjithmonë një derë hapur pajtimin. Të mos kapen pas egos së tyre dhe ta shohin sho-shoqin si dy armiq që nuk do të pajtohen asnjëherë. Sepse, në martesë gruaja dhe burrin nuk janë konkurrent e as armik i njëri-tjetrit, por janë palë dhe vëllezër. Kuvendet e diskutimit nuk janë fushëbeteja dhe bashkëshortët nuk janë armiq të pozicionuar në dy fronte të kundërta. Si natyrë njerëzore, nëse përbrenda iu lindin ndjenja armiqësore, duhet të sjellin ndërmend vëllazërinë dhe marrëdhëniet mes tyre. Duhet të veprojnë sipas këtij rregulli që ka vendosur i Dërguari i Allahut (s.a.s.): "Nëse kërkon armik, armiku yt më i ashpër është ai që ndodhet midis dy anëve të

7. Buhari, Ahkam 34; Medhalim 15; Muslim, Ilim 2 (2668) ;Neueui, Şerhu Muslim, VIII/437

8. Tirmidhi, Birr, 58 (1994); Darrimi, I/336 (Hadis No: 296)

9. Surja Nisa, 128

6. Surja Nisa, 65

tua, nefsi (egoja).¹⁰ Komunikimi me njëri-tjetrin duhet të jetë gjithmonë në linjën e vëllazërisë, miqësisë, dashurisë, respektit dhe pajtimit. Sepse nuk janë vetëm fjalët ato që të çojnë në një pikë të përbashkët dhe në përqafim në fund, por janë edhe ruajtja e këtyre principeve.

Një prej principeve bazë të debatit që Profeti (s.a.s.) i kanë dhënë njerëzimit, është edhe ky: "Duaje me masë atë që do, një ditë ai mund të bëhet armiku yt. Me atë që inatosesh, inatosu me masë se ndoshta një ditë ai mund të bëhet miku yt."¹¹

Të mbytesh në debat është nga hipokrizia, ndërsa ta mbyllës atë sa më herët është nga besimi.

Një prej rreziqeve shpirtërore që ka si parim armiqësinë dhe jo pajtimin në debat, është edhe hipokrizia. Në plan të parë, debati pa masë mund të duket sikur nuk ka lidhje me hipokrizinë. Por Profeti (s.a.s.) kur përmend tiparet e hipokritit, që kur flet gënjen, kur bën marrëveshje nuk e respekton, kur premton nuk e mban fjalën, përmend edhe: "Kur futet në konflikt devijon nga e vërteta (e tepron në armiqësi pa ndjekur asnjë lloj parimi)."¹² Për këtë arsye Profeti (s.a.s.) thotë: "Mos u zhyt asnjëherë në debat me vëllain tënd, mos bëj shaka të tepruara me të dhe mos i premto atij diçka që nuk e përmbush dot."¹³

Në të kundërt, të mos e zgjatësh debatin dhe ta përfundosh një çast e më parë, është pjesë e besimit të sigurt që të mos dëmtosh unitetin e vëllazërinë, dhe kjo ka shpërblim shumë të madh siç shprehet Profeti ynë (s.a.s.): "Unë jam garant që do t'i jepet një vilë në cep të xhenetit atij që hedh hapin e parë drejt mbylljes së debatit edhe pse ka të drejtë. Jam garant edhe që, atij të cilit nuk gënjen qoftë edhe për shaka, do t'i jepet një vilë në mes të xhenetit. Po ashtu jam garant, atij që është me moral të mirë, do t'i jepet një vilë në

10. Axhluni, Keshfu'l-Hafa, I/143

11. Tirmidhi, Birr 60

12. Buhari, Iman 24 (34); Muslim, Kitebu Iman, 106

13. Buhari, el-Edebu'l-Mufred, fq. 106 (394); Tirmidhi, Birr 58 (1995)

vendin më të lartë të xhenetit."¹⁴ Për rrjedhojë, debati më i mirë dhe më fitimprurës është ai që përfundon sa më shpejt. Nëse burri dhe gruaja e përvetësojnë këtë princip në jetën e tyre dhe e vënë në praktikë, debatet familjare nuk do të devijojnë nga boshti i pajtimit dhe nuk do të shndërrohen në zënka e armiqësi. Për më tepër, ata që sillen në këtë mënyrë, në botën tjetër para se të shohin vilën që premton Profeti (s.a.s.) do të shohin që foleja e tyre familjare është shndërruar në saraj të përjetshëm në xhenet.

Duhet të kihen parasysh edhe virtytet e bashkëbiseduesit.

Një prej reflektimeve të të qenurit i drejtë dhe i ndërgjegjshëm është përmendja e virtyteve të mira të bashkëbiseduesit në fillim të debatit, dhe jo fokusimi në anët negative dhe qortimi i tyre. Në të kundërt, ta fillosh debatin duke kritikuar e qortuar, do ta tensionojë bashkëbiseduesin dhe do të verë në lëvizje egon e tij për të mbrojtur veten dhe jo të drejtën. Aq më tepër kur fokusi i debatit nuk është vënia në pah e të metave të bashkëbiseduesit, por arritja e një pike të përbashkët në të drejtë.

Përfundimi

Debati edhe pse duket i dobishëm në plan të parë, nëse nuk zhvillohet duke u bazuar në principet të cilat i përmendëm më sipër, sjell më shumë dëme sesa dobi dhe e prish komunikimin e shëndoshë. Nga kjo pikëpamje, ai është nga sprovat e rënda të gjuhës. Është një prej pikave ku shejtani mund të penetrojë brenda njeriut dhe ta inkurajojë atë për armiqësi. Është një ves që ushqen në zemrën dhe ndjenjat e njeriut mllef e urrejtje. Është ves i keq që e shkatërron ndjenjën e sigurisë dhe besimit mes partnerëve, i ftoh ata nga njëri-tjetri, aq sa mund të çojë deri në ndarjen e tyre. Kështu që, debati duhet zgjatuar sa më pak dhe duhet të kihet parasysh principet e përmendura më sipër. E lusim Allahun (xh.sh) që të na ruaj nga e keqja e gjuhës dhe nga debati shterpë e pa masë!

14. Ebu Davud, Edeb 8 (4800); Tirmidhi, Birr 58 (1993)

Horizonti i fesë

Një anë të dashurisë për të vërtetën e përbën shkenca, kurse anën tjetër, feja. Sigurisht, në njërin anë të lidhjes dhe marrëdhënies mes qenies është zbulimi dhe përcaktimi i të vërtetës me anë të aftësisë njohëse dhe vetëdijes së njeriut, në anën tjetër është qëndrimi që duhet përcaktuar ndaj asaj të vërtete. Specifikën e parë e ndjek shkenca, përfshi edhe burimet informative të fesë. Kurse specifikën e dytë e përcakton feja. Shkenca që nuk ka në themelet e saj analizën dhe shpjegimin e qenies dhe ekzistencës, dëshirën dhe pasionin për zbulimin e të vërtetës, është e verbër; po kështu, edhe përcaktimet e saj nuk janë pa kontradiktë. Ashtu siç ndodh që shkenca për përvetësimin e së cilës bëhen përpjekje të nisura nga konsiderata interesash individuale, familjare e shoqërore, është e paracaktuar të përballët çdo kohë me një sërë ngecjeve e bllokimesh, ashtu dhe komplikimi herët a vonë i informacionit apo njohurisë së arritur në mënyrë të kushtëzuar nga një mendësi, një ide, një parti e një doktrinë, është i pashmangshëm. Meqë me burimet informative brenda saj, feja është një basen i gjerë dijeje, është edhe një element jetësor dhe një dinamikë me rëndësi për sa i përket dashurisë dhe pasionit për të vërtetën, si dhe në çështjet që e kapërcejnë horizontin e informacionit dhe njohurisë, një udhëzues me stil tregues të hapur, por me pamje të thellë që s'të gënjen kurrë!

Por ç'e do se ashtu siç është e mundur në çdo kohë që shkenca, duke u flijuar për ide të caktuara, për rryma të caktuara dhe për doktrina të caktuara, duke e miopizuar, të shndërrohet në diçka mëngjarashe apo më keq, në një demon agresiv, grindavec dhe që ia pret rrugën të vërtetës, ashtu dhe është e mundur në çdo kohë që edhe feja e cila është një e vërtetë qiellore, të tregohet në dorën e mendimit fanatik si burim ndjenjash urrejtjeje, neverie, zemërimi dhe shpagimi; si përfytyrimi dhe projektimi i një objekti në mënyrë të përmbysur! Ç'kontradiktë e madhe!

Mendoni, tani, një çerdhe shkencore – që, në të vërtetë, është po aq e shenjtë sa një tempull – të marrë nëpër këmbë, madje të marrë rob në këtë apo atë mënyrë nga një rrymë filozofike. Aty shkenca është një i arrestuar në dorën e një ideje jo të lirë, fanatike dhe po aq të mallkuar sa injoranca më e mallkuar! Dhe mendoni një fe që kërkohet të bëhet mjet për interesat e disa klikave politike apo jopolitike. Tashmë tempulli është bërë banesa e ngushtë e asaj klike, kurse adhurimi aty është shndërruar në një lloj ceremonie protokollare dhe, në këto kushte, nuk ka dyshim se edhe feja, edhe institucioni dhe jeta fetare, edhe karakteri sublim i fesë janë 'vrrarë' keqas!

Sigurisht, po qe se në një shoqëri disa flasin për shkencë dhe, ndërkaq, i përdorin çerdhet shkencore, siç përdorin vilat e veta, si vitrina të dëshirave, pasioneve dhe ideologjive të veta, ato çerdhe

shkencore prej kohësh kanë mbaruar së qeni tempuj, për t'u kthyer në arena ku mprihen dëshirat, pasionet dhe urrejtjet. Gjithashtu, po qe se në një shoqëri disa flasin për besimin, fenë dhe vënien e saj në jetë dhe, ndërkaq, atyre që s'mendojnë si ata vetë, që, për pasojë, nuk ndajnë me ta të njëjtat konsiderata politike, u atribuojnë herezi, materializëm dhe hipokrizi, feja në përfaqësimin e njerëzve të tillë – mëkati i kësaj u takon këtyre përfaqësuesve sharlatanë – kthehet në gjendjen e një fobie krejtësisht kundërshtarë të synimit të zbritjes së saj (fesë), si largimi i njerëzve nga Allahu, nxirja e zemrave të tyre dhe mbyllja mu në sy atyre e dyerve të shpresës. Ç'është e drejta, në ç'masë që të jetë armiqësia kundër besimit dhe fesë në gojë që shkumëzojnë me urrejtje, neveri dhe zemërim dhe në penat që nxijnë shpirtrat, një fanatizëm dhe një dhuratë e ofruar djallit që e kënaq atë, grushtet e ngritur në ajër të shtrënguar fort në emër të kritikës ndaj kësaj pikëpamjeje apo asaj ideje ndërsa pretendohet për besim dhe fe, janë në po atë masë një mediokritet dhe fanatizëm, si dhe një model injorance që do t'i mbyste në dëshpërim banorët e qiellit!

Pavarësisht nga pamja, po qe se njeriun që nuk e di se ç'është besimi i vërtetë, se me ç'gjuhë flet ndërgjegjja, që s'ka pjesë nga afërsia dhe dashuria hyjnore, që nuk i pranon për të mëdha gjërat e konsideruara të mëdha dhe për të vogla gjërat e konsideruara të vogla tek Allahu, shihet si fetar i plotë, kjo duhet të jetë mungesa më e madhe e respektit ndaj hyjnitetit dhe universalitetit të fesë. Armiku më i madh edhe i fesë, edhe i shkencës, është paraqitja e një pjese dëshirash dhe pasionesh tona diku si ide shkencore dhe diku si besim fetar. Kjo specifikë është te njerëzit një boshllëk me truall të gjerë dhe burimi i këtij boshllëku janë dobësitë e tyre dhe, në krye të këtyre dobësive, vijnë dobësia për t'u dukur mbi atë se ç'jemi dhe dobësia për t'iu hyrë pritjeve shumë kate mbi kapacitetin tonë. Është pikërisht kjo dobësi e dyfishtë që bëhen përpjekje për ta mbushur me një sërë vlerash shkencore dhe fetare të pranuar si të shenjta nga ndërgjegjja e përgjithshme. Më saktë, prej disave, feja kërkohet të përdoret pikërisht si një lëndë mbushëse për të mbushur boshllëqet e veta. Arma më e fuqishme e lidhur fort pas të vërtetës e ndërgjegjes përballë një dobësie njerëzore të tillë, është pasioni për të vërtetën dhe dashuria për dijen dhe shkencën. Sigurisht, nëse ka një eliksir që të fshijë myshkun e mendjeve të dukura si të ditura dhe ndryshkun e mendimeve të dukura si përkrahëse të fesë, ai është, pa dyshim, dashuria pasionante për Allahun, dashuria për të gjithë qenien si rrjedhojë e dashurisë për Të dhe pasioni për të vërtetën. Kur zemrat të marrin vrull me pasion dhe shpirtrat të ngrihen kas me dashuri, të gjitha boshllëqet dhe dobësitë njerëzore ose bëhen pluhur e hi, ose shndërrohen në eliksir, në pije jetëdhënëse!

Lumturia dhe besimi

Dihet se lumturia është parajsa e ëndrrave të çdo njeriu e që kërkohet prej të gjithë njerëzve. Lind pyetja: Ku është lumturia?

Është një pyetje që ka çuditur gjithë njerëzimin, që nga kohët e lashta e deri më sot. Është kërkuar nga shumë njerëz, por u kërkuar atje ku nuk duhej të kërkohej, prandaj mbetën pa përgjigje. Tani le të hedhim dritë mbi gjërat në të cilat mendohet se gjendet lumturia. Bëjmë pyetjen: A është lumturia në mirëqenien materiale? Shumë njerëz mendojnë se të jesh i lumtur, do të thotë të jesh pasanik, të kesh mirëqenie të lartë materiale, pra të jetosh mes gjithë të mirave. Por me një vështrim të shpejtë në realitetin tonë, do të gjejmë se lumturia nuk qëndron në mirëqenien e lartë materiale, siç pretendohet. Përpara nesh kemi shembullin e vendeve që kanë nivelin e mirëqenies më të lartë, siç është, për shembull, Suedia, por mirëqenia e lartë materiale nuk i ka bërë të kënaqur njerëzit. Po si është mirëqenia atje? Sistemi shoqëror arriti të eliminojë dallimet e padrejta të klasave dhe arriti të vendosë sigurime shoqërore, shëndetësore për të gjithë shtetasit. Kështu, për shembull, një shtetas suedez merr asistencë shoqërore, asistencë shëndetësore për ngritjen e çmimeve, asistencë banimi, asistencë për të verbrit, po ashtu edhe mjekimi në spital bëhet falas dhe gratë marrin asistencë për vete, duke përfshirë shpenzimet e lindjes, për kujdesin mjekësor në spital, po ashtu asistencë shtesë për çdo fëmijë që lind, përkrahja sociale që u jepet të papunëve është përkrahje në nivelin më të lartë në të gjithë botën. Ja pra, këto ishin

disa nga përkrahjet dhe asistencat që u jepen njerëzve nga shteti në Suedi. Por, edhe pse ndodh kështu, atje numri i vetëvrasjeve është në nivelin më të lartë në të gjithë botën. Po ashtu edhe në Amerikë, që është shteti më i përparuar në botë, njerëzit nuk janë të kënaqur nga jeta. Shkrimtarja e madhe franceze, Fransuaza Sagian, e cila e ka vizituar Amerikën shpeshherë, thotë: "Kriza që po përjetojnë banorët e Nju Jorkut është shpirtërore dhe sentimentale, njerëzit atje po mendojnë se si ta krijojnë kohën, pa ditur se si mund ta harxhojnë kohën e tyre". Po ashtu kemi edhe profesorin e madh, Kolen Uelsu, i cili thotë: "Zhvillimi material në Nju Jork është një mbulesë e bukur për një jetë të vështirë e pakënaqësish. Tani mund të pyesim nëse mirëqenia mund të jetë apo jo shkak i vetëm për të realizuar qetësinë dhe kënaqësinë shpirtërore? Natyrisht që përgjigja është 'Jo'". Pra, ana materiale e jetës nuk zë vendin e parë, as vendin më të gjerë në realizimin e lumturisë së njeriut, por është një nga elementet e kësaj lumturie, sepse ka raste kur pasuria bëhet shkak për lodhjen dhe pakënaqësinë e njeriut. Allahu xh.sh. për hipokritët thotë: "Mos u josh (o Muhamed) nga pasuria dhe fëmijët e tyre, sepse nëpërmjet tyre Allahu kërkon t'i ndëshkojë ata në këtë jetë, kështu që t'u dalë shpirti duke qenë jobesimtarë" (Teube, 55).

Po a janë fëmijët lumturia e vërtetë e njeriut? Faktikisht, fëmijët janë lulja e jetës dhe zbukurimet e saj, po ashtu janë filizat e së ardhmes. Dashuria ndaj tyre është instinkt në brendësinë e njeriut. Ndërsa në suren Kehf, në ajetin 46, Allahu thotë: "Pasuria dhe fëmijët janë stoli e jetës së kësaj



bote, por veprat e mira, që mbeten përherë, janë më të mira të Zoti yt sa i përket shpërblimit dhe, janë më të mira sa i përket shpresës (për shpëtim)". Por ndodh edhe e kundërta. Sa fëmijë ka që u kanë shkaktuar mjerime prindërve të tyre dhe sa të tjerë ua kanë shpërblyer prindërve me mosbindje ndaj tyre dhe me mohimin e të gjitha atyre të mirave, që u kanë siguruar gjatë jetës së tyre?! Sa prindër ka që vriten nga fëmijët e tyre për t'ua marrë sa më shpejt pasurinë e tyre?! Edhe ne vetë po shohim përditë se sa të lodhur e të pakënaqur janë ata njerëz që të vetmin synim të tyre kanë mbledhjen e pasurisë. Profeti a.s. thotë: "Po të kishte biri i Ademit (njeriu) dy lugina me flori, do të lakmonte që të kishte edhe një të tretë." Pra këtu arrihet në konkluzionin se fëmija nuk është lumturia e vërtetë e kësaj bote, por vetëm një element i kësaj lumturie dhe jo elementi kryesor.

A është shkenca moderne lumturia e vërtetë? A ka mundësi që shkenca moderne të realizojë lumturinë e vërtetë për njeriun? Përgjigjen do ta marrim nga fjalët e personaliteteve të dijes. Filozofi materialist anglez Bertrant Rasëll, pranon se, njeriu, në luftën e vet me natyrën, ka fituar me anë të shkencës, ndërsa në luftën e tij me vetveten, nuk i ka vlejtur shkenca. Ai pohon se feja akoma vazhdon të jetë kalorësi i vërtetë i kësaj fushe, sundimtare e botës së brendshme të njeriut.

Le të marrim një shembull tjetër. Psikologu amerikan, doktor Link, thotë: "Ne nuk mund të arrijmë një zgjidhje të shërueshme për probleme të thella të jetës dhe nuk kemi për të arritur lumturinë e vërtetë vetëm duke marrë njohuri

shkencore, pa kuptuar se ekziston diçka tjetër që plotëson mungesën e shkencës në fushën e shpirtit".

Pra, del se lumturia nuk është as në pasurinë e shumë e as në ndonjë post, nuk është në fëmijët e shumë e as në shkencën moderne. Lumturia është diçka jo konkrete, që nuk shihet me sy dhe nuk matet me sasi, nuk blihet e as nuk shitet. Lumturia buron nga brendësia e njeriut.

Tregohet se një burrë një ditë i thotë bashkëshortes së tij, duke e kërcënuar e duke i thënë se do të bëj ty gruan më të pakënaqur në botë. Ajo ia kthen: "Nuk ke mundësi të më bësh të pakënaqur, ashtu siç nuk ke mundësi të më bësh më të lumturën në botë". Burri e pyet: "Si nuk paskam mundësi?!" dhe ajo iu përgjigj duke i thënë: "Në qoftë se lumturia është në ato para që më jep, atëherë ke mundësi t'i ndërpresësh, nëse ajo është në stolitë e mia prej floriri, po ashtu ke mundësi të m'i marrësh, por është diçka tjetër, të cilën ti nuk e ke në dorë". Burri e pyet sërish: "Atëherë më thuaj se cila është kjo gjë?" Gruaja, gjithë siguri, i thotë: "Unë e gjej lumturinë time në besim. Ai është në zemrën time dhe askush nuk e ka në dorë zemrën time, përveç Zotit tim".

Kjo është lumturia e vërtetë, lumturi që askush nuk ka mundësi ta japë, apo ta marrë. Nëse lumturia është një pemë që mbillet në zemrën e njeriut, atëherë besimi tek Allahu dhe Dita e Gjykimit është lëndë ushqyese dhe lënda e tyre vadtëse është drita e saj.

Mendimi i Imam Taberiu për luftën dhe paqen me armiqtë

Këtu do të përqendrohemi në shpjegimet e komentuesve klasikë, të dhëna për ajetet kur'anore, që trajtojnë çështjen e paqes dhe armëpushimit me armiqtë, apo edhe ajetet që trajtojnë çështjen e përgatitjes ushtarake kundër tyre. Po kështu do të diskutojmë edhe për shkaqet e zbritjes së këtyre ajeteve.

Imam Taberiu (vdiq 310 h.)

Imam Taberiu apo 'Mësuesi i komentuesve', siç e thërrasin dijetarët muslimanë, në komentimin e ajetit 61 të kaptinës el-Enfal,

Në qoftë se ata anojnë nga paqja, ano edhe ti nga ajo e mbështetu tek All-llahu. Ai është që dëgjon dhe di."

...thotë: Allahu i Madhëruar i thotë të Dërguarit të Vet: Nëse i frikësohesh tradhtisë së tyre, atëherë vepro ngjashëm me ta dhe shpallu luftë, por, nëse anojnë nga paqja me ty dhe e braktisin luftën, qoftë duke hyrë në Islam, qoftë duke paguar xhizjen, qoftë duke u nënshtruar apo qoftë edhe me çfarëdo forme tjetër të shprehjes së vullnetit për paqe, atëherë ti ano nga paqja dhe afroju atë që kërkojnë prej teje..." [1]

Imam Taberiu, siç mund të vërejmë qartë, ajetin e komenton sipërfaqësisht, duke u ndalur në urdhrin e Allahut të Madhëruar për të Dërguarin e Tij, Muhammedin

alejhi's selam, për të anuar nga paqja për sa kohë që atij i ofruar është shansi. Këto janë parimet e fesë sonë të pastër, e cila nuk nxit për luftë dhe derdhje gjaqesh, ashtu siç propagandojnë të tjerët kundër saj.

Ndërsa në komentimin e ajetit 60, nga po e njëjta kaptinë (el-Enfal)

E ju përgatituni sa të keni mundësi force (mjete luftarake), e kuaj të caktuar për betejë kundër atyre (që tradhtojnë) e me të (me përgatitje) ta frikësoni armikun e All-llahut, armikun tuaj dhe të tjerët, të cilët ju nuk i dini (se kush janë), e Allahu i di ata. Çfarëdo që shpenzoni për rrugën e All-llahut, ajo do t'ju kompensohet dhe nuk do t'ju bëhet padrejtë."

...Imam Taberiu (duke parafrazuar Ibni Abbasin [Allahu qoftë i kënaqur me të dy]) thotë: Allahu i Madhëruar thotë se nëse keni frikë se jobesimtarët dhe femohuesit, me të cilët në fakt keni lidhur armëpushim, ju tradhtojnë, atëherë ju – besimtarë – përgatitni për luftë pajisjet e nevojshme, të cilat do t'i frikësonin idhujtarët, armiqtë e Allahut të Madhëruar dhe armiqtë tuaj..."[2]

Pastaj, Imam Taberiu citon një hadith pejgamberik, i cili forcën (ar. el-kuvveh) e komenton me hedhje (shtizash e shigjetash):

Vëni re! Forca është hedhje! Vëni re! Forca është hedhje!"[3]

Kësisoj, bazuar në këto shpjegime, del se muslimanët e kanë për obligim që të përgatisin tërë pajisjet ushtarake të nevojshme për ta frikësuar armikun. Nga metodologjia e tradicionalistit Imam Taberiu dihet se ai Kur'anin e komenton së pari me Kur'an e pastaj me Sunnet, ndërsa ne pamë se në ajet 'forcën' (ar. el-kuvveh) e komenton me 'hedhje' (ar. err-rremju), kuptim ky i shkëputur nga hadithi.

Pastaj Imami komenton edhe pjesën e ajetit:

... dhe të tjerët, të cilët ju nuk i dini (se kush janë), e All-llahu i di ata..."

...për të cilën jep këto shpjegime: Komentuesit kanë mendime të ndryshme se kush dhe çfarë janë 'të tjerët', si: Benu kurejdha,

Një grup xhinësh

...ndërsa ne si të saktë shohim mendimin se Allahu i Madhëruar i urdhëroi besimtarët që të përgatiten për xhihad dhe luftë me të gjitha pajisjet me të cilat e frikësojnë armikun e Tij dhe të tyre, idhujtarët. Nuk ka hapësirë që të thuhet se për qëllim është njëri kuptim dhe jo kuptimet e tjera të forcës, ngase Allahu i Madhëruar e solli atë në formë të përgjithësuar. E nëse thuhet se domethënia e saj është

shpjeguar me 'hedhje' (ar. err-rremju) në Sunnet, themi se, megjithëkëtë, hadithi nuk e përkufizon domethënien e saj (forcës) në vetëm 'hedhje', porse shpjegon një prej shumë domethëniesve të saj. Ndryshe, çdo gjë që ndihmon në luftën kundër idhujtarëve është forcë dhe fuqi.

Ndërsa sa i përket mendimit se me 'të tjerët' synohen xhinët, Imam Taberiu e merr për të saktë, për faktin se besimtarët e dinin që e kishin armik nga çifutët (beni kurejdhanë) dhe nga idhujtarët – persianët... [4]

Si rezymë do të mund të thuhej se mendimi i Imam Taberiu për forcën përfshin çdo gjë që përbën pajisjen e duhur ushtarake të besimtarëve, duke përfshirë këtu të gjitha llojet e armëve, kuajt (mjetet), shpatat, mburojat etj. Pra, shihet se kuptimin e fjalës 'forcë' ai nuk e turr në domethënien e 'hedhjes' së ofruar në hadith, të cilën në fakt ai e sheh vetëm si një prej shumë domethëniesve të saj.

Kjo transparencë e Imam Taberiu dhe hapje e tij në të kuptuarit e tekstit kur'anor, me këto dimensionë dhe parametra, është vërtet për t'u lëvduar. Allahu i Madhëruar e mëshiroftë Imam Taberiu dhe e shpërbleftë me xhenetet e Tij!

Një ditë e profetit **Muhamed a.s.**

Si e vleresonte Muhamedi a.s 24 orëshin e një dite?

Se si i vlerësonte Zotëriu ynë 24 orët e një dite na tregojnë nipat e profetit, me rrëfim të transmetuar nga babai i tyre, h.z. Aliu r.a.:

Muhamedi a.s, e ndante ditën në tri pjesë. Një pjesë të saj e vlerësonte duke adhuruar Allahun me Namaz dhe lexim Kur'ani. Në një pjesë tjetër ndihmonte pjesëtarët e familjes në punët e shtëpisë: bënte punët e përditshme të shtëpisë dhe punët që i përkisnin atij i bënte po vetë. Kurse në pjesen tjetër të ditës pushonte.

Por se dhe pjesën e pushimit e ndante në dy pjese: në një pjese, pranonte vizitat e sahabeve fisnikë dhe u mësonte dije sipas nevojës, këta të fundit kur largoheshin nga profeti, dijet që kishin mësuar ua mësonin sahabeve të tjerë. Profeti a.s., në mësimin e sahabeve, më shumë i jepte rendesi takvasë (përkushtimit në fe) se sa pasurisë, mallit, prejardhjes familjare etj. Ai për këto

arsye edhe u bënte komplimente atyre që ishin më të përkushtuar në ibadet dhe në bindje ndaj fjalës së Allahut dhe ndjekjes së profetit.

Ai i ndihmonte nevojtarët sipas nevojës, njërit mund t'i jepte një, një tjetri dy dhe ndofta të tjerëve nëse kishte nevojë edhe më shumë. I dëgjonte ata pa u merzitur aspak, sillej shumë butë dhe përpigjej t'i ndihmonte. Kur i drejtohej një pyetje në lidhje me dynjanë ose ahiretin, i jepte përgjigje sipas nevojës dhe nivelit të pyetesit.

Pyeteshin e drejtonte drejt rrugëve të hajrit. Atyre që mesonin prane tij, u thoshte që ato dije që kishin marrë, t'ua mesonin edhe atyre që nuk gjendeshin aty, dhe u thoshte që t'ja përcillnin nevojat dhe dëshirat e atyre që nuk kishin mundësi të vinin pranë atij, qofshin ata burra, gra, apo të robëruar, etj.

Sigurisht që ai gjithmonë i këshillonte ata që nuk kishin mundësi të paraqisnin kërkesat e tyre tek i pari i shtetit, duke u thënë atyre që i ndihmojnë këto



persona: "Allahu në ditën e Kijametit nuk do t'ja rrëshqasë këmbët atyre në urën e Siratit."

Pranë tij nuk lejonte të thuheshin fjalë të panevojshme, të parëndesishme dhe të padobishme. Pejgamberi a.s. edhe kur dilte jashtë, sillej me përulesi dhe edukatë. Ai kudo që ndodhej si në pazar, rrugë etj., me të gjithë sillej me fëtyrë të buzëqeshur. I fitonte zemrat e njerezve duke ua pyetur hallet dhe duke folur me një gjuhë të ëmbël.

Menjëherë interesohej për gjendjen e atyre sahabeve që nuk i shikonte në mesxhid, xhami, xhemat, xhuma etj, dhe mendohej të mësonte se mos u kishte ndodhur gjë. Me ata që takohej u thoshte gjëra që i forcojnë vendosshmërinë dhe ndjeshmërinë e fesë, që të vrapojnë drejt së mirës dhe punëve të mira dhe të largohen nga e keqja dhe punët e këqia.

Profeti ynë a.s. kur vinte afër një mexhlisi nuk mendohej që me patjetër të ulej në vendin kryesor, me këtë qëllim edhe nuk pengonte asjeri, pra ulej në

fund të mexhllisit ose në një vend bosh. Dhe të tjeret i këshillonte që në mbledhje të tilla ose mexhlise të ulen në një vend të përshtatshëm pa penguar askënd. Ai sipas nevojës i lavdëronte dhe u thoshte të mirat që kishin, atyre që ishin të pranishëm në mbledhje. Aq tepër i lavdëronte sa që gjithsecili mendonte që më tepër profeti donte atë. Mendohej ta ndihmonte pa u mërziur me durim dhe qetësi atë që lodhej ose e tepronte me veprimet tij të pahijshme.

Kur i kërkohej diçka, nëse kishte mundesi, ia jepte, e nese nuk kishte, ia fitonte zemrën me fjalë të buta dhe premtim në të ardhmen. Dhembshuria, mëshira, bujaria dhe modestia e tij ishte e njohur nga të gjithë. Të gjithë ishin të sigurtë që Profeti a.s. interesohej për ta. Në ndarje të një të drejte, nuk e nderronte pa patur ndonjë arsye të veçantë.

Krijuesi, dashuria ime e vetme

Njeriu gjithnjë ka nevojë për Zotin. Krahas nevojës së ndjerë ndaj mirësive të Tij, njeriu ka më shumë nevojë për ndihmën dhe mbrojtjen e Zotit. E ka më të nevojshme të ushqejë zemrën dhe shpirtin, se të ushqejë trupin e tij me ajër, ujë dhe bukë. Një njeri i singertë duhet të kërkojë nga Zoti një zemër të vendosur.

Nëse njeriu vepron me mendimin "unë ia dal vetë mbanë, pa ndihmën e askujt", tregon që ai nuk e kërkon ndihmën e Zotit. Ky mendim apo qëndrim është krejtësisht i gabuar dhe një veprim i tillë mund të dëmtojë besimin e njeriut. Njeriu shpeshherë harron se çdo ekzistencë ka nevojë për Zotin. Ndodh që ai t'i ulet dhe bindet Zotit për vite të tëra, por kjo bindje nuk është përforcuar brenda tij. Përpos të gjithave, atij i takon të kërkojë mbrojtje nga Zoti dhe t'i lutet me singëritet Atij.

Një besimtar i singertë duhet të dijë se asgjë tjetër në këtë botë nuk mund ta shpëtojë apo t'i japë zgjidhje problemeve të tij përveç Allahut. Nisur

nga kjo ai duhet të thotë gjithnjë "Allah" dhe t'i drejtohet veçse Atij.

Edhe në Kuranin Famëlartë bie në sy kjo e vërtetë: "... A ka më të mirë se Ai që i vjen në ndihmë nevojtarit të këputur, kur i lutet Atij që jua largon të keqen dhe ju bën juve dëshmitarë në tokë? Vallë, a ka krahas Allahut zot tjetër? Sa pak që reflektoni!" (Neml, 27/62). Nëse do ta kujtonit ndihmën e Tij çdo herë që jeni ndodhur në vështirësi, çdo herë që i jeni drejtuar 'O Zoti im!' dhe ju ka ardhur në ndihmë, atëherë pyetjes së mësipërme do t'i përgjigjeshit me tërë bindjen me fjalën "Allahu".

Mos dashuro tjetërkënd

Unë besoj se çdo dëshirë e imja e lidhur me këtë botë është mungesë besnikërie ndaj Zotit, profetit dhe fesë sime. Nuk dua që dashuria ndaj gjërave të kësaj bote të zërë vendin e dashurisë më të madhe. Megjithëse mund ta kem kaluar jetën me shumë probleme, duke u përballur me vuajtjen dhe dhimbjen, duke kaluar infarkt të cilat ma ndalojnë zemrën



dhe duke u tejngopur me ilaçe, unë përsëri zgjedh t'i shërbej fesë sime në vend të bukurive të kësaj bote. Nuk kam ndonjë dëshirë për jetë të gjatë. Çdo natë e pres sikur të ishte nata ime e fundit.

Të gjithë ne duhet të përpiqemi të përmbushim detyrimet tona në mënyrën më korrekte për të fituar lumturinë e përjetshme dhe t'i mbështetemi mëshirës së Allahut (xh.sh). Duhet t'i ngremë duart lart dhe të lutemi. Gjatë lutjeve mund të përmenden më shpesh fjalët e ajetit të tetë të sures Al Imran: "O Zoti ynë! Mos lejo që zemrat tona të shmangen nga e vërteta pasi na ke udhëzuar në rrugën e drejtë dhe jepna mëshirë, vërtet Ti je Dhurues i madh!" "O Drejtuesi i zemrave! Na i forco zemrat tona në fenë Tënde. Dhe më pas të themi: "Bëji zemrat tona të të binden". Edhe nëse do t'i përsërisnim jo dhjetë, po njëmijë herë, përsëri do ishte e mangët.

Profeti ynë a.s. na e ka këshilluar përsëritjen e këtyre lutjeve në mëngjes dhe darkë nga tri herë. Ai

ishte një i dërguar, profet, pa faje dhe i mbrojtur. Po ne, a jemi të pafaj dhe të mbrojtur si ai?! Ne nuk jemi as pa mëkate dhe as të mbrojtur nga to. Nuk e kemi një siguri të tillë. A nuk duhet të rrëqethemi nëse Profeti vetë i thotë këto fjalë?

Drejtoju Allahut

Askush të mos thotë "ndihem kështu a ashtu", "kam këtë apo atë problem". Ke qarë ndonjëherë për dyzet net me radhë për Zotin tënd? E ke vënë ballin në sexhde dhe je mbytur në ngashërim? Pse mundohesh të shfajësohesh? Drejtohu nga Zoti dhe lutju me përgjërëm Atij. "Më trego rrugën o Zoti im, më mbaj dorën se nuk mund të shkoj pa Ty".

Mos prisni që Zoti t'iu japë gjëra të cilat i janë dhënë njerëzve që kanë copëtuar zemrat në rrugën e Tij. Ai mund të dhurojë sa të dojë, por secili do të marrë aq sa përpiqet. Nëse ju e bëni natën ditë, edhe Zoti do t'ua ndriçojë më shumë atë. Bëjini ditë netët e kësaj bote në mënyrë që Allahu t'ju ndriçojë errësirën e botës tjetër.

Pagjumësia e
mbretit shpëtoi
një njeri në
nevojë



Tregohet se një mbret nuk po e zinte gjumi si zakonisht. Veziri që nuk i shqitej për asnjë çast, e pyeti: "Çfarë ju ka ndodhur, madhëri? Mos ka diçka që ju shqetëson?" Mbreti iu përgjigj: "Në fakt nuk e di as vetë. Thjesht ndiej diçka të çuditshme të cilën as vetë nuk e di çfarë është." Veziri i tha: "Ç'mendim keni t'i hipim një varke dhe të bëjmë një lundrim në det? Duke dëgjuar fëshfërimën e puhizës dhe zhurmën e dallgëve, besoj se do t'ju vijë gjumi".

Kjo ide i pëlqeu mbretit dhe menjëherë u përgatit varka mbretërore dhe filloi lundrimi. Në një moment, mbreti vajti në një qoshe të varkës, u ul dhe mbylli sytë duke u orvatur ta zërë gjumi. Por

pa kaluar disa çaste, u dëgjua një zë si i mbytur: "O Zot, më shpëto! O Zot, më shpëto!"

Mbreti hapi sytë dhe u kërkoi ushtarëve të drejtohen nga burimi i zërit. Personi që kishte thirrur ishte një djalosh i ri, i kapur pas një dërrase. Atë e nxorën para mbretit dhe ky i fundit e pyeti: "Çfarë të ka ndodhur more bir?" Djaloshi iu përgjigj: "Ka disa ditë që kam dalë me varkën time për peshkim. Teksa lundroja, ndodhi një avari dhe varka u fundos. Për asnjë çast nuk kam reshtur së thirruri: "O Ti që u gjendesh pranë nevojtarëve, ma shpëto jetën!" Mbreti uli kokën dhe tha: "I pa të meta je, o Zot, që e lë robin pa gjumë, për t'i shpëtuar jetën njërit prej robve të Tu".



Zgjohu o njeri

I

Zgjohu O njeri, ti nga gjumi i rëndë,
Jeta kot të shkoi, mblidhi pakëz mëndë;
Por si hija erdhe, rove dhe poshkonë...
Nga pshehtija jote kurr gjë nuk kuptonë..
O Zot, O Zot na udhzo, nga Ty vijm' ne Ty shkojm' na
Ti je vetëm jeta, pa Ty kurr gjë s'ka...
Me mbesim në zembër, në shpirtin me dritë,
Të lëftojmë të ligat, larg nga errësitë...

II

Me drit'e errsirë jemi të gatuar,
Shpirti është i ndritur, trup'i errësuar,
Jan' këta dy detra te njeriu të mbledhur,
Zgjidhe udhën tënde ku je për t'u hedhur...
O Zot, O Zot na udhëzo e tj...

III

Barrën e mëkateve kemi marr' në shpinë,
Vdekja po na pretë, ka hapur pëqinë;
Në kafaz të mbyllur kemi një xhananë,
Sa pa fluturuar të kërkojm' dermane...
O Zot, O Zot na udhëzo e tj...

